



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 206

Tiranë – E mërkurë, 2 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 949, datë 25.11.2015	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve..... 13309
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 950, datë 25.11.2015	Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF019164, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruar nga federata ruse, në kuadër të fondit të mirëbesimit për menaxhimin e financave publike për Evropën dhe Azinë Qendrore, për financimin e projektit “Përmirësimi i kontrollit të pajtueshmërisë dhe rritja e transparencës në prokurimin publik në Shqipëri”..... 13316
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 951, datë 25.11.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 13321
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 25.11.2015	Për emërimin e anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të përzgjedhur nga sektori ekonomik privat..... 13321
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 954, datë 25.11.2015	Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit..... 13322
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 955, datë 25.11.2015	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 61, datë 23.1.2013; nr. 345, datë 24.4.2013; nr. 686, datë 16.8.2013; nr. 42, datë 21.1.2015; nr. 474, datë 3.6.2015, për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale, të ndryshuara..... 13323

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 956, datë 25.11.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore”, të ndryshuar.....	13327
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 25.11.2015	Për miratimin e rregullores “Për nivelet udhëzuese të përqendrimit të radonit në mjediset e brendshme dhe përqendrimet e radiobërthamave në mallra, me efekt mbrojtjen e publikut”	13327
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 25.11.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Shtimi i sipërfaqes së varrezave publike në qytetin e Vlorës”	13337



VENDIM
Nr. 949, datë 25.11.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
 NDËRMJET KËSHILLIT TË
 MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
 SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
 EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE,
 PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E
 INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË
BASHKUARA ARABE
PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E
INVESTIMEVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe (në vijim bashkërisht të quajtura “Palët Kontraktuese”),

duke dëshiruar krijimin e kushteve të favorshme për nxitjen e më tepër investimeve nga investitorët e një Pale në territorin e Palës tjetër;

duke pranuar se nxitja dhe mbrojtja reciproke e këtyre investimeve të kryera në përputhje me ligjet dhe rregulloret e palës kontraktuese pritëse do të çojnë në nxitjen e iniciativave individuale të biznesit dhe do të rrisin mirëqenien për të dyja Palët,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. a) Termi “investim” nënkupton çdo lloj aseti të investuar nga investitori i një prej Palëve Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës po kryhet investimi dhe, në veçanti, por jo në mënyrë ekskluzive, përfshin:

i) Pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe çdo të drejtë pasurore *in rem*, si: hipotekë, peng, barrë ose uzufukt;

ii) Aksione, letra me vlerë, obligacione, hua dhe çdo formë të ngjashme pjesëmarrjeje në një shoqëri;

iii) Të drejta ose pretendime për para ose për çdo përmbushje sipas kontratës që ka një vlerë financiare ose ekonomike;

iv) Të drejta të pronësisë intelektuale, emrin e mirë, procese teknike, ekspertizë, të drejtën e autorit, markat tregtare, emrin tregtar dhe patentat, në përputhje me ligjet përkatëse të Palëve Kontraktuese përkatëse;

v) Çdo të drejtë të dhënë me ligj, kontratë ose për shkak të ndonjë licence ose lejeje të dhënë sipas ligjit, burimet natyrore nuk do të mbulohen nga kjo Marrëveshjeje;

vi) Termi “investim” nuk përfshin një pretendim në para që lind nga:

a) kontrata tregtare për shitjen e mallrave dhe shërbimeve nga një shtetas ose shoqëri e një Pale Kontraktuese;

b) zgjatja e kredisë në lidhje me transaksione tregtare, të tilla si financimi i tregtisë.

Çdo ndryshim në formën në të cilën asetet investohen ose rinvestohen nuk ndikon në natyrën e tyre si investim, me kusht që investitori do të marrë lejen ligjore nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese pritëse.

b) “Investitor” nënkupton çdo shtetas dhe shoqëri të një Pale Kontraktuese:

i) “Shtetas” nënkupton persona fizikë që kanë kombësinë e një Pale Kontraktuese në përputhje me ligjin e saj të zbatueshëm;

ii) “Shoqëri” nënkupton çdo person juridik ose organizatë tjetër të organizuar sipas ligjeve të Palës Kontraktuese;

c) Termi “territor” nënkupton:



a) Në lidhje me Republikën e Shqipërisë: territorin nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe hapësirën detare dhe shelfin kontinental, mbi të cilat Republika e Shqipërisë ushtron, në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare dhe ligjet ndërkombëtare, të drejtat e saj ligjore dhe sovrane.

b) Në lidhje me Emiratet e Bashkuara Arabe: territori i Emirateve të Bashkuara Arabe, i cili është nën sovranitetin e tyre, si edhe hapësira jashtë ujërave territoriale, hapësira ajrore dhe zonat nënujore, mbi të cilat Emiratet e Bashkuara Arabe ushtrojnë sovranitet dhe juridiksion në lidhje me çdo aktivitet që zhvillohet në ujërat, shtratin e detit, nëntokën e tyre, në lidhje me eksplorimin për shfrytëzimin e pasurive natyrore për shkak të ligjit të tyre dhe të së drejtës ndërkombëtare.

d) “Përfitime” nënkupton të ardhura që rrjedhin nga një investim dhe përfshin, në veçanti, por jo në mënyrë ekskluzive, fitime, dividendë, interesa, përfitime në kapital, honorare, tarifa për patenta, tarifa për licenca dhe tarifa të tjera. Përfitimet e riinvestuara do të gëzojnë të njëjtin trajtim si investimi fillestar.

2. Termi “valutë lirisht e përdorshme” nënkupton çdo valutë që përdoret gjerësisht për të kryer pagesa për transaksione ndërkombëtare dhe që shkëmbehet gjerësisht në tregjet kryesore të këmbimit.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për të gjitha investimet e kryera nga investitorët e secilës prej Palëve Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, të kryera qoftë para ose pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, por nuk do të zbatohet për ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me një investim që lind para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe as për ndonjë padi/prendim që është zgjidhur para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Nxitja e investimeve

1. Secila Palë Kontraktuese do të nxisë dhe do të krijojë kushte të favorshme për investitorët e Palës tjetër Kontraktuese për të kryer investime në territorin e saj dhe do t'i pranojë këto investime në përputhje me ligjet dhe rregulloret e saj.

2. Palët Kontraktuese do të nxisin dhe do të lehtësojnë krijimin dhe themelimin e subjekteve të duhura ligjore nga investitorët, në mënyrë që të themelojnë, të zhvillojnë dhe të vënë në zbatim projekte investimi në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, siç mund të lejohet nga ligjet dhe rregulloret e Palës Kontraktuese pritëse.

3. Secila Palë Kontraktuese do të përpiqet të ndërmarrë, në territorin e saj, të gjitha masat e nevojshme që mund të jenë të zbatueshme sipas ligjit vendas të shtetit pritës dhe mund të japë lehtësirat e përshtatshme, stimuj dhe forma të tjera inkurajimi për investime të kryera nga investitorët të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 4

Mbrojtja e investimeve

1. Investimet nga investitorët të secilës Palë Kontraktuese do të gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me dispozitat e ligjeve vendase të Palës Kontraktuese pritëse. Me këtë Marrëveshje dhe me rregullat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare, asnjëra prej Palëve Kontraktuese nuk do të pengojë në asnjë mënyrë, nëpërmjet masave arbitrare ose diskriminuese, administrimin, mbajtjen, përdorimin, gëzimin ose disponimin e investimeve.

2. Secila Palë Kontraktuese do të përpiqet, sa të jetë e mundur, që të bëjë publike të gjitha ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat që i përkasin ose që ndikojnë drejtpërdrejt në investimet në territorin e saj të investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese;

3. Secila Palë Kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e saj të zbatueshme, do t'u garantojë investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën e aksesit në gjykatat e saj, agjencitë dhe gjykatat administrative dhe çdo organ tjetër që ushtron autoritet vendimdhënës.

4. Në rast likuidimi të një investimi, të ardhurave nga likuidimi do t'i jepen të njëjtat forma mbrojtjeje dhe trajtimi si investimit fillestar duke përfshirë ato që janë dhënë sipas nenit 6 më poshtë.

Neni 5

Kërkesat e përmbushjes

Asnjë palë nuk mund të vendosë ose të zbatojë ndonjë prej kërkesave të mëposhtme:



- a) të eksportoje një nivel ose përqindje të caktuar mallrash;
- b) të arrijë një nivel ose përqindje të caktuar të kapacitetit vendas;
- c) transferimin e teknologjisë;
- d) të blejë, të përdorë ose t'u japë përparësi mallrave të prodhuara ose që ofrohen në territorin e saj;
- e) të blejë mallra ose shërbime nga një person në territorin e tij.

Neni 6

Trajtimi i investimeve

1. Në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, secila Pale Kontraktuese do t'i garantojë, gjatë gjithë kohës, investimeve të kryera në territorin e saj nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese, trajtim të drejtë dhe të barabartë. Ky trajtim nuk do të jetë më pak i favorshëm se ai që u jepet investimeve të investitorëve të saj ose investitorëve të ndonjë Pale të tretë, cilido që është më i favorshmi.

2. Secila Palë Kontraktuese do t'u japë investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese në lidhje me kompensimin, transferimin, administrimin, përdorimin, gëzimin ose disponimin e investimeve të tyre, një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jep investimeve të kryera nga vetë investitorët e saj ose nga investitorët e ndonjë Pale të tretë, cilido që është më i favorshmi.

3. Pavarësisht dispozitave të ndonjë marrëveshjeje (marrëveshje dypalëshe për investime (BIT)) që Palët Kontraktuese kanë nënshkruar me shtete të tjera para ose pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Klauzola e shtetit më të favorizuar (MFN) nuk do të zbatohet për çështje procedurale ose gjyqësore.

4. Megjithatë, dispozitat e këtij neni nuk do të interpretohen në atë mënyrë që të detyrojnë një Palë Kontraktuese t'u kalojë investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese përfitime të ndonjë trajtimi, preference ose privilegji që rrjedh nga:

a) ndonjë bashkim doganor, bashkim ekonomik, zonë e tregtisë së lirë, bashkim monetar ose formë tjetër e rregullimeve ekonomike rajonale ose marrëveshjeve të ngjashme ndërkombëtare, në të cilat secila prej Palëve Kontraktuese është ose mund të bëhet palë;

b) ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ose rajonale ose çdo çështje tjetër që lidhet tërësisht ose kryesisht me taksimin;

c) secila Palë Kontraktuese do të ruajë të drejtën të zbatojë dhe të paraqesë përjashtime nga trajtimi kombëtar i investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre, duke përfshirë riinvestimet.

Neni 7

Kontrata e drejtpërdrejtë me entin qeveritar dhe investitorin

Secila Palë Kontraktuese ose qeverisja e saj vendore apo entet ose agjencitë e saj të caktuara mund të hartojnë me një investitor të Palës tjetër Kontraktuese, një marrëveshje investimi, e cila do të rregullojë marrëdhënien specifike ligjore që lidhet me investimin e investitorit në fjalë. Megjithatë, një shkelje e kontratës nuk do të nënkuptojë shkeljen e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Kompensimi për dëm ose humbje

1. Kur investimet e kryera nga investitorët e secilës prej Palëve Kontraktuese pësojnë humbje për shkak të luftës ose konfliktit të armatosur, revolucionit, një gjendjeje të emergjencës kombëtare, revoltës, kryengritjes ose rebelimit ose ngjarjeve të tjera të ngjashme në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, atyre do t'u jepet nga Pala tjetër Kontraktuese trajtim në lidhje me kthimin, dëmshpërblimin, kompensimin ose ndonjë zgjidhje tjetër jo më pak e favorshme se ajo që Pala Kontraktuese në fjalë u jep investitorëve të saj ose investitorëve të ndonjë Pale të tretë, cilido që është më e favorshme.

2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, investitorëve të një Pale Kontraktuese, të cilët, në një prej ngjarjeve të përmendura në atë paragraf, pësojnë dëme ose humbje në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, që rrjedhin nga:

a) kërkesa e investimeve ose e pasurisë tyre nga forcat ose autoritetet e saj; ose

b) shkatërrimi i investimeve ose i pasurisë së tyre nga forcat ose autoritetet e saj që nuk është shkaktuar në luftim ose nuk është kërkuar për shkak të nevojës së situatës.

Do t'u jepet kompensim efikas dhe i përshtatshëm për dëmin ose humbjen e pësuar gjatë periudhës së kërkesës së kryer ose si rezultat i shkatërrimit të pasurisë. Pagesat që do të rrjedhin



prej saj do të jenë në një valutë lirisht të përdorshme dhe do të transferohen lirisht pa vonesë.

Neni 9

Shpronësimi

1. a) Investimet e kryera nga investitorë të një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese nuk do të shtetëzohen, shpronësohen, hiqen nga zotërimi ose nënshtrihen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë masave që kanë vlerë të njëjtë me shtetëzimin, të tilla si: ngrirja ose bllokimi, shpronësimi ose heqja nga zotërimi (në vijim bashkërisht të referuara si shpronësim) nga Pala tjetër Kontraktuese, përveçse për arsye publike në lidhje me nevojat e brendshme të asaj Pale Kontraktuese dhe kundrejt kompensimit të shpejtë të mjaftueshëm dhe efikas dhe me kusht që këto masa të jenë marrë mbi baza jodiskriminuese dhe në përputhje me procedurat e vendosura me ligj.

b) Ky kompensim do të ketë vlerën aktuale të investimit të shpronësuar dhe do të përcaktohet dhe do të llogaritet në bazë të vlerës reale të tregut të investimit të shpronësuar në kohën, menjëherë para se shpronësimi të ndodhte ose kur shpronësimi i planifikuar u bë i njohur publikisht, cilido që vjen më herët (në vijim e referuar si “data e vlerësimit”). Ky kompensim do të përfshijë interesin në vlerën mbizotëruese të tregut, megjithatë në asnjë rast jo më pak se sa norma LIBOR gjashtëmujore mbizotëruese e interesit ose e barabartë me të, nga data e shpronësimit deri në datën e pagesës.

c) Kur vlera reale e tregut, e përmendur më lart, nuk mund të përcaktohet lehtësisht, kompensimi do të caktohet mbi parime barazie, duke marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës dhe rrethanat, të tilla si: kapitali i investuar, natyra dhe kohëzgjatja e investimit, vlera e zëvendësimit, vlera në bilanc dhe reputacioni/emri i mirë. Shuma e kompensimit që do të përcaktohet në fund do t'i paguhet menjëherë investitorit në një valutë lirisht të konvertueshme dhe do të lejohet të transferohet lirisht pa vonesë.

2. Pa cenuar të drejtat e tij, sipas nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje, investitori i prekur ka të drejtë, sipas ligjit të Palës Kontraktuese që kryen shpronësimin, të shqyrtojë, nëpërmjet gjyqësorit ose autoriteteve të tjera të pavarura të asaj Pale, çështjen e tij dhe vlerësimin e investimit të tij në përputhje me parimet e përcaktuara në paragrafin

1. Pala Kontraktuese që kryen shpronësimin do të bëjë çdo përpjekje për të garantuar që ky shqyrtim të kryhet në mënyrën e duhur.

3. Kur një Palë Kontraktuese shpronëson asetet e një shoqërie e cila është themeluar sipas ligjit të saj të zbatueshëm në fuqi në çdo pjesë të territorit të saj dhe ku investitorë të Palës tjetër Kontraktuese zotërojnë aksione, letra me vlerë ose hua, ose të drejta të tjera me interes, ajo garanton që dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni të zbatohen në masën e nevojshme për të siguruar një kompensim të drejtë dhe të barabartë në lidhje me investimet e tyre për këta investitorë të Palës tjetër Kontraktuese, të cilët zotërojnë këto të drejta ose interesa.

Neni 10

Transferimi i pagesave në lidhje me investimet

1. Secila Palë Kontraktuese do t'u lejojë investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese transferimin e pagesave në lidhje me një investim brenda dhe jashtë territorit të saj, duke përfshirë transferimin e:

a) kapitalit fillestar dhe të çdo kapitali shtesë për mbajtjen, administrimin dhe zhvillimin e investimeve;

b) përfitimeve;

c) pagesave sipas një kontrate, duke përfshirë amortizimin e pagesave të interesit fillestar dhe atij të grumbulluar, të kryera sipas një kontrate huaje;

d) honorareve dhe tarifave të përmendura në nenin 1, paragrafi 1, germa “d”;

e) të ardhurave nga shitja ose likuidimi i të tërë ose i një pjese të investimit, duke përfshirë aksionet;

f) të ardhurave dhe shpërblimeve të tjera të personelit të angazhuar nga jashtë vendit në lidhje me investimet;

g) pagesave për kompensim sipas neneve 8 dhe 9;

h) pagesave të përmendura në nenin 11;

i) pagesave që lindin nga zgjidhja e mosmarrëveshjeve; dhe

j) të ardhurave dhe fitimeve të linjave ajrore që operojnë në trafikun ndërkombëtar.

2. Transfertat e pagesave, sipas paragrafit 1, do të kryhen pa vonesë ose pengesa dhe, me përjashtim të rasteve të pagesave në natyrë, në një valutë lirisht të konvertueshme. Në rast të një vonese të tillë në kryerjen e transfertarve të



nevojshme, investitori i prekur ka të drejtë të marrë interes për periudhën e kësaj vonese.

3. Transfertat do të bëhen në vlerën mbizotëruese në momentin e këmbimit në treg në datën e transfertës për valutën që do të transferohet. Në rast të mungesës së një tregu këmbimi valutor, vlera që do të zbatohet do të jetë vlera më e fundit e zbatuar për investimet e brendshme ose vlera e këmbimit, e përcaktuar në përputhje me rregulloret e Fondit Monetar Ndërkombëtar ose vlera e këmbimit për konvertim valute në të drejta të veçanta tërheqjeje ose dollarë amerikanë, cilado që është më e favorshme për investitorin.

Neni 11

Zëvendësimi

1. Nëse një Palë Kontraktuese, agjencia e caktuar prej saj ose një shoqëri apo sipërmarrje tjetër e themeluar në atë Palë Kontraktuese, përveç investitorit (Pala Zhdëmtuese), kryen një pagesë në kuadër të një dëmshpërblimi ose garancie kundrejt një rreziku jotregtar që ka marrë përsipër në lidhje me investimet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese (Pala Kontraktuese pritëse), ose ndryshe merr një pjesë ose të gjitha të drejtat dhe pretendimet e këtij investimi si rezultat i mosshlyerjes së plotë ose të pjesshme të investitorit, Pala Kontraktuese pritëse do të njohë:

a) transferimin të Pala Zhdëmtuese me ligj ose nëpërmjet transaksioneve ligjore të një pjese ose të të gjitha të drejtave dhe pretendimeve që rezultojnë e nga një investim i tillë;

b) se Pala Zhdëmtuese ka të drejtë të ushtrojë këto të drejta dhe pretendime dhe do të marrë përsipër të gjitha detyrimet në lidhje me investimin nëpërmjet zëvendësimit, në të njëjtën masë sa paraardhësi i saj posedues ose investitori fillestar; dhe

c) pretendimet ose të drejtat e zëvendësuara nuk do të tejkalojnë të drejtat ose pretendimet fillestare të këtij investitori.

2. Pala Zhdëmtuese do të ketë të drejtë në të gjitha rrethanat, ndaj:

a) të njëjtut trajtim në lidhje me të drejtat dhe pretendimet e marra dhe detyrimet e marra përsipër për shkak të transferimit të përmendur në paragrafin 1 më lart; dhe

b) çdo pagesë të marrë në zbatim të atyre të drejtave dhe pretendimeve.

Ashtu si investitori fillestar kishte të drejtë të merrte, për shkak të kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me investimin në fjalë.

3. Pavarësisht nenit 8, çdo pagesë e marrë në valutën vendase nga Pala Zhdëmtuese në zbatim të drejtave dhe pretendimeve të marra, do të jetë lirish në dispozicion të Palës Zhdëmtuese, me qëllim mbulimin e çdo shpenzimi të lindur në territorin e Palës Kontraktuese pritëse.

4. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, zëvendësimi do të ndodhë në secilën prej Palëve Kontraktuese, vetëm pas miratimit paraprak me shkrim të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është kryer investimi.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet palës kontraktuese dhe investitorit

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Palës Kontraktuese dhe investitorit të Palës tjetër Kontraktuese në lidhje me investimet e atij investitori në Palën tjetër Kontraktuese do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit, pas kërkesës me shkrim nga investitori për zgjidhje miqësore të një mosmarrëveshjeje. Shteti pritës do t'i përgjigjet menjëherë kësaj kërkesë.

2. Kërkesa për zgjidhje miqësore e përmendur më lart do të përmbajë si më poshtë:

a) emrin dhe adresën e investitorit ankues dhe, kur pretendimi bëhet nga një investitor i një Pale Kontraktuese për llogari të një personi juridik, emrin dhe adresën e personit juridik;

b) dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, që pretendohet se janë shkelur, dhe çdo dispozitë tjetër përkatëse;

c) çështjet dhe bazën e fakteve për pretendimin; dhe

d) kompensimin që kërkohet dhe shumën e përafërt të dëmeve të kërkuara.

3. Nëse një mosmarrëveshje e tillë nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh nga data e kërkesës për zgjidhje miqësore, investitori mund ta depozitojë mosmarrëveshjen pas njoftimit me shkrim për synimin e tij për të depozituar një pretendim në një prej institucioneve të mëposhtme:

a) gjykatën kompetente ose gjykatën administrative të Palës Kontraktuese të paditur; ose

b) pajtimin ose arbitrazhin e themeluar sipas rregullave të arbitrazhit të Komisionit të Kombeve



të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL); ose

c) arbitrazh sipas rregullave të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC); ose

d) arbitrazh sipas rregullave të Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID), të themeluar me Konventën për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të Tjera (Konventa e ICSID-së), e hapur për nënshkrim në Uashington, D.C., më 18 mars 1965; ose

e) çdo forum tjetër pajtimi ose arbitrazhi të pranuar nga investitori dhe Pala Kontraktuese në mosmarrëveshje.

4. Një Palë Kontraktuese nuk do të parashtojë si mbrojtje, kundërpretendim, të drejtë për kompensim ose për çdo arsye tjetër, se dëmshpërblimi ose çdo kompensim tjetër për të gjitha ose një pjesë të dëmeve të pretenduara është marrë ose do të merret në përputhje me një dëmshpërblim, garanci ose kontratë sigurimi.

5. Në çdo fazë, gjatë periudhës së reflektimit ose procedurës së gjykatës, palët në mosmarrëveshje e tërheqin çështjen nëse arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen në mënyrë miqësore të mosmarrëveshjes.

6. Vendimi do të jetë detyrues dhe nuk do të nënshtrohet ndonjë apelimi ose zgjidhjeje tjetër përveç atyre të parashikuara në rregullat e forumeve të arbitrazhit, të përmendura nga paragrafët “b” deri “e” të këtij neni. Vendimi do të zbatohet pa vonesë nga Pala Kontraktuese si një vendim përfundimtar sipas ligjit vendas të shtetit pritës.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve Kontraktuese

1. Palët Kontraktuese, në masën që është e mundur, do të zgjidhin çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin ose zbatimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet konsultimeve ose kanaleve të tjera diplomatike, siç mund të jetë rënë dakord ndërmjet Palëve Kontraktuese.

2. Nëse mosmarrëveshja nuk është zgjidhur brenda gjashtë muajve nga data në të cilën këto konsultime ose kanale të tjera diplomatike janë kërkuar nga njëra prej Palëve Kontraktuese dhe përveç kur Palët Kontraktuese bien dakord ndryshe me shkrim, secila Palë Kontraktuese, nëpërmjet

njoftimit me shkrim ndaj Palës tjetër Kontraktuese mund ta depozitojë mosmarrëveshjen në një gjykatë arbitrazhi të posaçme, në përputhje me dispozitat e mëposhtme të këtij neni.

3. Gjykata e arbitrazhit do të themelohet si vijon: secila Palë Kontraktuese do të emërojë një anëtar dhe të dy këta anëtarë do të bien dakord mbi shtetasin e një shteti të tretë me të cilin të dyja Palët Kontraktuese kanë marrëdhënie diplomatike, si kryetar të gjykatës së arbitrazhit që do të emërohet nga të dyja Palët Kontraktuese. Këta anëtarë do të emërohen brenda dy muajve dhe kryetari brenda katër muajve nga data në të cilën njëra prej Palëve Kontraktuese, ka informuar Palën tjetër Kontraktuese që synon ta depozitojë mosmarrëveshjen në një gjykatë arbitrazhi.

4. Nëse periudhat e përcaktuara në paragrafin 3 më lart nuk janë respektuar, secila prej Palëve Kontraktuese mund të ftojë, në mungesë të ndonjë zgjidhjeje tjetër, kryetarin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që të bëjë emërimet e nevojshme. Nëse kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë është shtetas i ndonjërës prej Palëve Kontraktuese ose nëse ai është ndryshe i ndaluar të kryejë këtë funksion, zëvendëskryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë do të ftohet të bëjë emërimet e nevojshme. Nëse zëvendëskryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë është shtetas i ndonjërës prej Palëve Kontraktuese ose nëse edhe ai është i ndaluar të kryejë këtë funksion, anëtari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në radhë për nga vjetërsia në detyrë, i cili nuk është shtetas i ndonjërës prej Palëve Kontraktuese, do të ftohet të bëjë emërimet e nevojshme.

5. Gjykata e arbitrazhit e merr vendimin e saj me një shumicë votash. Ky vendim do të merret në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe rregullave të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare dhe do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të dyja Palët Kontraktuese. Secila Palë Kontraktuese do të mbulojë shpenzimet e anëtarit të gjykatës së arbitrazhit të emëruar nga Pala Kontraktuese, si edhe shpenzimet për përfaqësimin e saj në procesin e arbitrazhit. Shpenzimet e kryetarit, si edhe çdo kosto tjetër e procesit të arbitrazhit do të mbulohet në pjesë të barabarta nga të dyja Palët Kontraktuese.



Megjithatë, gjykata e arbitrazhit, sipas gjykimit të saj, mund të udhëzojë që një pjesë më e madhe e këtyre shpenzimeve ose të gjitha shpenzimet të paguhen nga njëra prej Palëve Kontraktuese. Në të gjitha aspektet e tjera gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë procedurat e saj.

Neni 14

Hyrja dhe qëndrimi i personelit

Palët Kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre, do të shqyrtojnë në mënyrë të favorshme aplikimet për hyrje dhe qëndrim të personave të njëres prej Palëve Kontraktuese në lidhje me një investim.

Neni 15

Zbatimi i rregullave të tjera

Pavarësisht paragrafëve 1 dhe 3, të nenit 6, nëse dispozitat e ligjit të ndonjërës prej palëve Kontraktuese ose detyrimet sipas së drejtës ndërkombëtare që ekzistojnë aktualisht ose të përcaktuara në vijim ndërmjet Palëve Kontraktuese në plotësim të kësaj Marrëveshjeje përmbajnë rregulla, qoftë të përgjithshme ose specifike, që u japin investimeve dhe veprimtarive të lidhura me to nga investitorë të Palës tjetër Kontraktuese një trajtim më të favorshëm se sa ai që ofrohet nga Marrëveshja në fjalë, këto rregulla në masën që janë më të favorshme, do të kenë përparësi ndaj kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16

Legjislacioni i zbatueshëm

Përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, të gjitha investimet do të rregullohen nga ligjet në fuqi në territorin e Palës Kontraktuese në të cilën janë kryer këto investime.

Neni 17

Ndryshime

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë pas një periudhe fillestare prej dhjetë vjetësh nga data e hyrjes së saj në fuqi, me kërkesë të njëres prej Palëve Kontraktuese. Pala Kontraktuese kërkuese do të depozitojë një kërkesë me shkrim, duke i shpjeguar Palës tjetër Kontraktuese arsyet mbi të cilat do të bëhet ndryshimi.

Neni 18

Konsultimi

Secila Palë mund të kërkojë konsultim me Palën tjetër Kontraktuese për sa i takon çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe ekzekutimin ose çdo mosmarrëveshjeje tjetër, duke përfshirë mosmarrëveshje investimi dhe Pala tjetër do të përgjigjet menjëherë.

Neni 19

Mohimi i përfitimeve

Përfitimet nga kjo Marrëveshje do t'i mohohen një investitori të një Pale Kontraktuese që fiton pronësi ose kontroll mbi një investim, me të vetmin qëllim që të depozitojë kërkesën për arbitrazh ose nëpërmjet planifikimit të kombësisë aty ku investitori ka strukturat e investimit të tij nëpërmjet shteteve ndërmjetëse me qëllimin e vetëm që të përfitojë nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis investitorit dhe shtetit (ISDS).

Neni 20

Hyrja në fuqi

Secila Palë Kontraktuese do të njoftojë palën tjetër se kërkesat e saj kushtetuese për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur dhe se Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas tridhjetë ditësh nga data e marrjes së njoftimit në fjalë.

Neni 21

Kohëzgjatja dhe zgjidhja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) dhe do të vazhdojë më pas të jetë në fuqi për një periudhë ose periudha të ngjashme, përveç se kur njëra prej Palëve Kontraktuese e zgjidh marrëveshjen, duke dhënë një njoftim me shkrim për zgjidhje nëpërmjet kanaleve diplomatike të paktën gjashtë muaj para mbarimit të afatit të periudhës fillestare ose të çdo periudhe në vazhdim.

2. Në lidhje me investimet e kryera para datës kur njoftimi për zgjidhje i kësaj Marrëveshjeje bëhet efektiv, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë në fuqi për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh nga data e zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje.



3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen pavarësisht ekzistencës së marrëdhënieve diplomatike ose konsullore ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Në dëshmi të kësaj, palët nënshkruese të autorizuar në mënyrë të rregullt nga qeveritë përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Hartuar në dy kopje, në Tiranë, më 15 tetor 2015, që i korrespondon, në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast ndryshimi të interpretimit, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM

Nr. 950, datë 25.11.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF019164, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA FEDERATA RUSE, NË KUADËR TË FONDIT TË MIRËBESIMIT PËR MENAXHIMIN E FINANCIVE PUBLIKE PËR EVROPËN DHE AZINË QENDRORE, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I KONTROLLIT TË PAJTUESHMËRISË DHE RITJIA E TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF019164, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si Administratore e fondeve grant, të siguruar nga Federata Ruse, në kuadër të Fondit të Mirëbesimit për Menaxhimin e Financive Publike për Evropën dhe Azinë Qendrore, për financimin e projektit “Përmirësimi i kontrollit të pajtueshmërisë dhe rritja e transparencës në prokurimin publik në Shqipëri”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Faqe | 13316

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Banka Botërore	1818 H Street	(202) 477-1234
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	N.W.	Adresa kabllore: INTBAFRAD
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim	Washington, D.C.	Adresa kabllore: INDEVAS
	20433	
	U.S.A.	

9 nëntor 2015

Shkëlqesia e Tij, Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Republika e Shqipërisë

**Lënda: Granti nr. TF019164
Përmirësimi i Monitorimit të Pajtueshmërisë dhe Rritja e Transparencës në Prokurimin Publik në Shqipëri**

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për mbështetje financiare të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (Marrësi), kam kënaqësinë t’ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), duke vepruar si administratore e fondeve të mbështetjes financiare të dhëna nga Federata Ruse (Donatori) sipas Fondit të Posaçëm për Menaxhimin e Financive Publike të Evropës dhe Azisë Qendrore (TF071577), propozon akordimin për Marrësin të një granti në shumën që nuk tejkalon dyqind e shtatëdhjetë mijë dollarë amerikanë (270,000 US\$) (Granti), sipas termave dhe kushteve të përcaktuar apo të referuara në këtë marrëveshje (Marrëveshja), e cila përfshin shtojcën bashkëlidhur, për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në shtojcën (Projekti).

Ky Grant financohet nga fondi i posaçëm i sipërpërmendur për të cilin Banka Botërore merr kontribute të herëpashershme nga Donatori. Në përputhje me pikën 3.02 të Kushteve Standarde (të përcaktuara në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e Bankës Botërore për pagesën në lidhje me këtë Marrëveshje kufizohen në shumën e fondeve që i vihen asaj në dispozicion nga ana e donatorëve sipas fondit të



posaçëm të sipërpërmendur, dhe e drejta e Marrësit për të tërhequr shumat e Grantit varet nga disponueshmëria e këtyre fondeve.

Marrësi, duke konfirmuar më poshtë pëlqimin e tij, deklaron se është i autorizuar për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të zbatuar Projektin në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuar dhe të referuara në këtë Marrëveshje.

Ju lutemi, konfirmoni pëlqimin e Marrësit në lidhje me sa më lart, duke nënshkruar dhe duke vendosur datën në kopjen e Marrëveshjes bashkëlidhur nga një funksionar i autorizuar nga Marrësi, dhe dërgojeni në adresë të Bankës Botërore. Në momentin e marrjes së kësaj kopjeje të sigluar, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas njofimit nga ana e Marrësit të përfundimit të procedurave të tij të brendshme; megjithatë, me kusht që oferta e kësaj Marrëveshjeje të vlerësohet e anuluar, në rast se Banka Botërore nuk ka marrë kopjen e sigluar të kësaj Marrëveshjeje dhe njofimin përkatës brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Banka Botërore, me përjashtim të rastit kur Banka Botërore dhe Marrësi kanë përcaktuar një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Me respekt,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga _____

Ellen Goldstein

Drejtoreshë për vendin

Zyrat e Bankës Botërore, Tiranë

Republika e Shqipërisë

PRANUAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Datë: _____

Bashkëlidhur:

1. Kushtet Standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga Fonde të ndryshme, datë 15 shkurt 2012.

2. Letër Disbursimi e datës së njëjtë me këtë Marrëveshje së bashku me Udhëzimet e Disbursimit të Bankës Botërore për Projektet, datë 1 maj 2006.

3. “Udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga Huat e BNRZH-së dhe Kreditë e IDA-së dhe Grantet”, të datës 15 tetor 2006 dhe rishikuar në janar 2011.

4. “Udhëzimet” Prokurimi i Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve jokonsulente sipas Huave të BNRZH dhe Kredive të IDA-s dhe Granteve nga Huamarrës të Bankës Botërore”, të datës janar 2011, rishikuar në korrik 2014.

5. “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve sipas BNRZH-së dhe Kredive IDA dhe Granteve nga Huamarrës të Bankës Botërore”, të janarit 2011, rishikuar në korrik 2014.

Granti nr. TF019164

SHTOJCË

Neni I

Kushtet standarde; përkufizime

1.01 Kushte Standarde. Kushtet standarde për Grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, datë 15 shkurt 2012 (kushtet standarde) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizime. Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet standarde ose në këtë Marrëveshje.

a) “Njësia qendrore financuese dhe kontraktuese” ose “CFCU-ja” nënkupton Njësinë Qendrore Financiare dhe Kontraktuese të Ministrisë së Financave.

b) “e-GP” nënkupton platformën e prokurimit *online* bazuar në rrjetin e APP-së.

c) “Institucione të jashtme” nënkupton prokurorinë, gjykatat, komisionin e prokurimit publik dhe auditorë të tjerë ndërkombëtarë të pavarur.

d) “Ligji mbi prokurimin publik” ose “LPP-ja” nënkupton ligjin e Marrësit mbi prokurimin publik nr. 9643, të vitit 2006, të ndryshuar.

e) “Agjencia e Prokurimit Publik” ose “APP-ja” nënkupton agjencinë e prokurimit publik të Marrësit.

f) “Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit” ose “SSAI-ja” nënkupton njësinë e pavarur të Marrësit në ngarkim të kontrollit ekonomik dhe



financiar, të krijuar me anë të ligjit nr. 154/2014, të datës 27 nëntor 2014, e cila raporton për Parlamentin e Marrësit.

Neni II

Ekzekutimi i projektit

2.01 Objektivat dhe përshkrimi i Projektit. Objektivi i Projektit është të mbështesë Marrësin në rritjen e monitorimit të pajtueshmërisë me LPP-në, përmirësimin e mekanizmit të shqyrtimit të pajtueshmërisë dhe rritjen e kapacitetit të SSAI-së për auditimin e prokurimit të kontratave publike në territorin e Marrësit. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa A. Monitorimi i performancës dhe pajtueshmërisë së Prokurimit

i) Tregues të performancës së Prokurimit. Ofrimi i mbështetjes për, ndër të tjera:

a) përgatitjen e treguesve të performancës së prokurimit për të mundësuar APP-në për të zhvilluar dhe për të testuar një metodologji për matjen e performancës së prokurimit të institucioneve të prokurimit dhe zyrtarëve të prokurimit të Marrësit;

b) kryerjen e vlerësimit të praktikave aktuale dhe metodologjive të APP-së për të matur performancën e institucioneve të prokurimit dhe zyrtarëve të prokurimit të Marrësit;

c) kryerjen e një vlerësimi të kapaciteteve të stafit të prokurimit;

d) zhvillimin e një programi trajnimi të stafit bazuar në vlerësimin e kapaciteteve të stafit të prokurimit;

e) asistencën teknike për ekipin që do të ndihmojë në modifikimin e e-GP-së për mbledhjen dhe analizimin dixhital të të dhënave.

ii) Modifikime në e-GP. Ofrimi i mbështetjes për, ndër të tjera, përgatitjen e një metodologjie për mbledhjen dhe analizimin dixhital të të dhënave ekzistuese të e-GP-së.

iii) Monitorimi dhe pajtueshmëria e APP-së. Ofrimi i mbështetjes për, ndër të tjera, asistencën teknike për të forcuar monitorimin e përputhshmërisë së stafit të APP-së, në: a) kryerjen e shqyrtimeve *ex post* (bazuar në rezultate reale) të kontratave të cilat mbulojnë të gjitha subjektet kryesore të prokurimit dhe sigurimin e personelit të APP-së me trajnimin e nevojshëm në vendin e punës; dhe b) monitorimin e zyrtarëve të prokurimit dhe

performances së enteve prokurorese bazuar në indekset e zhvilluara të performancës së prokurimit.

Pjesa B. Trajtimi i procedurave elektronike të arkivuara

i) Procedurat elektronike të arkivuara. Ofrimi i mbështetjes për, ndër të tjera, rishikimin e kuadrit ligjor dhe bazuar në përvojën ndërkombëtare, propozimin e ndryshimeve të rregullave dhe rregulloreve për trajtimin e procedurave elektronike të arkivuara të prokurimit.

ii) Qasja e institucioneve të jashtme në procedurat e prokurimit. Ofrimi i mbështetjes për, ndër të tjera, zhvillimin e rregullave dhe rregulloreve për t'u dhënë akses konfidencial institucioneve të jashtme që kryejnë hetimet apo mbledhjen e të dhënave.

Pjesa C. Ekspertiza profesionale në auditimin e prokurimit

i) Auditimi i sistemeve të prokurimit. Ofrimi i asistencës teknike për stafin e KLSH-së në auditimin e sistemeve të prokurimit, nëpërmjet:

a) kryerjes së vlerësimit të praktikave aktuale të KLSH-së në auditimin e prokurimit publik;

b) zhvillimit të materialeve të kurseve të trajnimit dhe të zbatimit të trajnimeve për auditimin e prokurimit publik, projektet e auditimit të financuara nga Bashkimi Evropian dhe Banka Botërore; dhe

c) përgatitjes së letrave të punës dhe modeleve të raportimit për përdorim në të ardhmen në trajnimin e stafit të ri dhe përdorimi i tyre gjatë auditimeve.

ii) Auditime të prokurimit pilot. Ofrimi i mbështetjes për, ndër të tjera, kryerjen e asistencës teknike për ekipet e auditimit të KLSH-së, të cilët do të kryejnë auditime të përbashkëta pilot të sistemeve të prokurimit publik, dhe përgatitjen e një manuali të auditimit të prokurimit.

2.02 Ekzekutimi i Projektit në përgjithësi. Marrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, ai do të zbatojë Projektin nëpërmjet APP-së dhe KLSH-së, në përputhje me dispozitat e: a) nenit II të Kushteve Standarde; b) “Udhëzimet mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Mashtrimit dhe Korrupsionit në Projektet e Financuara nga BNRZH-ja, Kreditë dhe Grantet IDA, të datës



15 tetor 2006 dhe rishikuar në janar 2011 (Udhëzimet antikorrupsion); dhe c) ky nen II.

2.03 Marrëveshje institucionale dhe të tjera:
a) Marrësi: i) do të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e Projektit në APP dhe KLSH; dhe ii) do të garantojë që APP-ja dhe KLSH-ja të realizojnë projektin në përputhje me këtë Marrëveshje.

b) Marrësi do të mbajë në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit një staf profesional brenda APP-së dhe KLSH-së në numrin e nevojshëm, me terma të referencës, kualifikime dhe përvojë të pranueshme nga Bankën Botërore.

c) Marrësi do të garantojë që APP-ja të realizojë pjesët A dhe B të Projektit. Marrësi do të garantojë që KLSH-ja të realizojë pjesën C të Projektit.

d) Marrësi do të garantojë që gjatë gjithë zbatimit të projektit, CFCU-ja ofron mbështetje fiduciare (prokurimi dhe financiare) për APP-në dhe KLSH-në, duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin.

e) Manuali operacional i projektit

i) Marrësi, nëpërmjet CFCU-së, do të përgatisë dhe do të mbajë gjatë zbatimit të Projektit një manual operacional të projektit, të pranueshëm për Bankën Botërore, ku do të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e APP-së dhe KLSH-së lidhje me Projektin, rregullat, metodat, udhëzimet, dokumentet standarde dhe procedurat për kryerjen e projektit, duke përfshirë ndër të tjera:

a) përshkrimin e detajuar të aktiviteteve zbatuese, sekuencën e tyre, orarin e ardhshëm dhe objektivat në lidhje me to; dhe masat e detajuara institucionale në lidhje me to;

b) kontabilitetin, auditimin, raportimin financiar, prokurimin dhe procedurat e disbursimit, duke përfshirë të gjitha dokumentet standarde përkatëse dhe kontratat model në lidhje me to; dhe

c) planin për monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të projektit dhe treguesit e performancës për Projektin.

ii) Në rast se ndonjë dispozitë e Manualit Operacional do të jetë në konflikt me ndonjë dispozitë sipas kësaj Marrëveshjeje, termat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

iii) Manuali Operacional mund të ndryshohet herë pas herë vetëm pas miratimit paraprak me shkrim të Bankës Botërore.

2.04 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit: a) Marrësi, nëpërmjet Njesisë Qendrore

Financuese dhe Kontraktuese, monitoron dhe vlerëson progresin e projektit dhe përgatit raportet e projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde dhe në bazë të treguesve të pranueshëm për Bankën Botërore. Çdo raport i projektit do të mbulojë periudhën e një semestri kalendarik dhe do t'i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

b) Marrësi, nëpërmjet Njesisë Qendrore Financuese dhe Kontraktuese, përgatit raportin përfundimtar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde. Raporti Përfundimtar do t'i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes.

2.05 Menaxhimi Financiar: a) Marrësi, nëpërmjet Njesisë Qendrore Financuese dhe Kontraktuese, do të garantojë që sistemi i menaxhimit financiar të mbahet në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të Kushteve Standarde.

b) Marrësi, nëpërmjet Njesisë Qendrore Financuese dhe Kontraktuese, do të sigurojë përgatitjen e raporteve të përkohshme financiare të paaudituar për Projektin dhe dorëzimin e tyre për Bankën Botërore jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, duke mbuluar tremujorin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore.

c) Marrësi, nëpërmjet Njesisë Qendrore Financuese dhe Kontraktuese, do të auditojë pasqyrat financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07/b të Kushteve Standarde. Çdo auditim i tillë i pasqyrave financiare do të mbulojë periudhën gjatë së cilës janë bërë tërheqjet nga llogaria e Grantit. Pasqyrat financiare të audituara për një periudhë të tillë do t'i dorëzohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të asaj periudhe.

2.06 Prokurimi.

a) Të përgjithshme. Të gjitha shërbimet e konsulentit të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e grantit do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në:

i) Seksionet I dhe IV të “Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të BNRZH-së dhe IDA-së dhe Granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të muajit



janar 2011 (rishikuar në korrik 2014)(Udhëzimet e Konsulentit); dhe

ii) Dispozitat e këtij seksioni, siç do të përpunohen në planin e prokurimit të përgatitur dhe të përditësuar herë pas here nga Marrësi për Projektin në përputhje me paragrafin 1.25 të Udhëzimeve të Konsulentit (Plani i prokurimit).

b) Përkufizime. Termat me germa kapitale, të përdorura në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni, për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi nga Banka Botërore të kontratave të veçanta, i referohen metodës korresponduese të përshkruar në seksionet II, III, IV dhe V të Udhëzimeve të Konsulentit, sipas rastit.

c) Metodatat e veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

i) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në pikën “ii” më poshtë, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e përzgjedhjes bazuar në Cilësi dhe Kosto.

ii) Metodatat e mëposhtme, përveç Përzgjedhjes bazuar në Cilësi dhe Kosto, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato detyra të cilat specifikohen në planin e prokurimit: A) Përzgjedhja mbi bazën e kostos më të ulët; B) Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; C) Përzgjedhja e vetme burimore e firmave konsulente; D) Përzgjedhja e konsulentëve individualë; dhe E) Procedura të vetme burimore për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

d) Rishikimi i vendimeve të prokurimit nga Banka Botërore. Plani i prokurimit përcakton ato kontrata të cilat do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen rishikimit pasues nga Banka Botërore.

2.07 Çdo kontratë për shpenzimet e pranueshme që do të financohen në mënyrë të plotë ose pjesërisht nga të ardhurat e grantit do të përfshihet në planin e prokurimit të përgatitur nga Marrësi dhe të miratuar nga Banka në përputhje me Udhëzimet e Konsulentit, para fillimit të procesit të prokurimit për çdo kontratë të tillë.

Neni III

Tërheqja e të ardhurave të Grantit

3.01 Shpenzime të Pranueshme. Marrësi mund të tërheqë të ardhurat e Grantit në përputhje me dispozitat e: a) nenit III të Kushteve Standarde; b) këtij seksioni; dhe c) udhëzimet shtesë që Banka Botërore mund të përcaktojë duke njoftuar Marrësin (përfshirë “Udhëzimet e Disbursimit të Bankës Botërore për Projektet” të muajit maj 2006, e rishikuar herë pas here nga Banka Botërore dhe të zbatueshme për këtë Marrëveshje në zbatim të këtyre udhëzimeve), për financimin 100% të Shpenzimeve të Pranueshme të cilat përbëhen nga Trajnimi, Kostot Operative dhe shërbimet e konsulentëve, duke përfshirë taksat.

Për qëllime të këtij paragrafi, termat:

a) “Trajnim” nënkupton kostot e arsyeshme, siç janë miratuar nga Banka Botërore, për trajnimin e zhvilluar sipas Projektit, duke përfshirë kostot e mësimdhënies, udhëtimit dhe transfertat për pjesëmarrësit në trajnime, kostot që lidhen me sigurimin e shërbimeve të trajnuesve dhe relatorëve në seminare, marrjen me qira të pajisjeve për trajnim, përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve të trajnimit dhe kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me përgatitjen dhe zhvillimin e kurseve të trajnimit dhe zbatimin e tyre (por duke përjashtuar mallrat dhe shërbimet e konsulentëve); dhe

b) “Kostot Operative” nënkupton kostot e arsyeshme, miratuar nga Banka Botërore, për shpenzimet përkatëse të kryera për zbatimin e Projektit, të përbëra nga tarifatat bankare të tilla si tarifatat e transfertave bankare dhe tarifatat mujore të mbajtjes së llogarive dhe të dublikimit / printimit të dokumenteve.

3.02 Kushtet e Tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të bëhen tërheqje për pagesat e kryera para datës së nënshkrimit të dytë të kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e përmendur në seksionin 3.06/c të Kushteve Standarde është data 30 nëntor 2016.

Neni IV

Përfaqësuesi i Marrësit; Adresat

4.01 Përfaqësuesi i Marrësit. Përfaqësuesi i Marrësit i përmendur në seksionin 7.02 të



Kushteve Standarde është Ministri i Financave.

4.02 Adresa e Marrësit. Adresa e Marrësit e referuar në seksionin 7.01 të Kushteve Standarde është:

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Faks: +355 4222 8494

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore e përmendur në seksionin 7.01 të Kushteve Standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Faks: 1-202-477-6391

VENDIM

Nr. 951, datë 25.11.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “a” të listës, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-SË)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) LISTA E NDRYSHUAR NË “LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA”:

1. MOHAMED; AMINE; AKLI;
2. CHIHEB; BEN MOHAMED; BEN MOKTHAR; AL-AYARI.

Shënim. Gjenealitete e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 953, datë 25.11.2015

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE, TË PËRZGJEDHUR NGA SEKTORI EKONOMIK PRIVAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pikat 1 e 3, e 18, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të përzgjedhur nga sektori ekonomik privat, si më poshtë vijon:

- a) Znj. Ines Muçostepa, kryetare e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;



b) Z. Silvio Pedrazzi, drejtor Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank;

c) Z. Andi Ballta, drejtor Ekzekutiv i shoqërisë “Tranzit”, sh.a.;

ç) Z. Luan Bregasi, President i Biznes Albania.

2. Vendimi nr. 888, datë 3.11.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të përzgjedhur nga sektori ekonomik privat”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 954, datë 25.11.2015

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË FORMULARIT TË LEJES SË LEGALIZIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Leja e legalizimit miratohet për ndërtimin informal, që është kualifikuar për legalizim, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”.

2. Drejtoria e varësisë së ALUIZNI-t miraton lejen e legalizimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i kualifikimit të ndërtimit informal (data e vendimit të kualifikimit).

3. Leja e legalizimit miratohet për subjektin përfitues, që është sipas rastit aplikuesi për legalizim ose/dhe personi të cilit i janë njohur të drejta mbi ndërtimin pa leje nëpërmjet:

a) veprimeve juridiko-civile (kontratë për kalimin e së drejtës për të legalizuar ndërtimin),

trashëgimisë ose me anë të deklaratës së aplikuesit për njohjen e të drejtave mbi ndërtimin;

b) vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Dokumentacioni sipas shkronjës “a” dorëzohet nga subjektet përpara përfundimit të procedurave administrative të miratimit të lejes së legalizimit.

4. Për shtesat informale, kur ndërtimi kryesor (ndërtimi me leje) është tjetërsuar apo nuk është në pronësi të aplikuesit për legalizim, për miratimin e lejes së legalizimit zbatohen përcaktimet e pikës 11, të vendimit nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit, leja e legalizimit, e shoqëruar nga dokumentacioni teknik, i dorëzohet ose i dërgohet në rrugë postare subjektit përfitues.

6. Për ndërtimet informale, që i nënshtrohen procedurës së kalimit të së drejtës së pronësisë, leja e legalizimit miratohet përpara kryerjes së këtyre procedurave dhe i dorëzohet subjektit përfitues, së bashku me dokumentacionin shoqëruar.

7. Afatet dhe procedurat në zbatim të pikës 6 rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

8. Pezullimi i procedurave administrative dhe i miratimit të lejes së legalizimit bëhet vetëm në rastet kur:

a) për ndërtimet informale dhe shtesat anësore/në lartësi plotësohen kushtet e nenit 26, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, për ato shqyrtime gjyqësore që kanë si objekt mosmarrëveshjet për të drejtën e pronësisë mbi vetë ndërtimin/shtesën apo mbi parcelën ndërtimore;

b) për shtesat anësore/në lartësi plotësohen kushtet e nenit 40, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, kur nga gjykata është vendosur masë sigurimi padie, në kuadër të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve midis subjekteve aplikuese dhe pronarit të truallit privat dhe/ose kufitar.

9. Lista e subjekteve përfituese të lejeve të legalizimit, shoqëruar me të dhënat e pasurive



(adresa, zona kadastrale, numri i pasurisë), afishohet në ambientet e ALUIZNI-t dhe pranë njësisë së qeverisjes vendore, si dhe publikohet në:

- a) Buletin e Njoftimeve Zyrtare;
- b) Faqen zyrtare të internetit të ALUIZNI-t.

10. Subjektet e interesuara, në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për lejen e legalizimit apo kur drejtoria e ALUIZNI-t nuk e miraton atë brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t.

11. Për rastet kur punonjësit e niveleve drejtuese në drejtorinë e varësisë së ALUIZNI-t gjenden në kushtet e konfliktit të interesit, leja e legalizimit miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë vendim.

12. Formulari i lejes së legalizimit shoqërohet nga planvendosja (genplani) e nga planimetria dhe aty përcaktohen:

- a) lloji dhe funksioni i objektit që legalizohet;
- b) subjekti përfitues i lejes së legalizimit;
- c) gjendja ndërtimore dhe vendndodhja e objektit;
- ç) pronësia mbi truallin etj.

13. Paraqitja skematike dhe mënyra e plotësimit të lejes së legalizimit miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

14. Vendimi nr. 411, datë 19.5.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

15. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 955, datë 25.11.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 611, DATË 11.6.2009; NR. 677, DATË 18.6.2009; NR. 706, DATË 23.6.2009; NR. 805, DATË 22.7.2009; NR. 1038, DATË 14.10.2009; NR. 247, DATË 13.4.2010; NR. 549, DATË 7.7.2010; NR. 646, DATË 28.7.2010; NR. 118, DATË 17.2.2011; NR. 61, DATË 23.1.2013; NR. 345, DATË 24.4.2013; NR. 686, DATË 16.8.2013; NR. 42, DATË 21.1.2015; NR. 474, DATË 3.6.2015, PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE, TË NDRYSHUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 61, datë 23.1.2013; nr. 345, datë 24.4.2013; nr. 686, datë 16.8.2013; nr. 42, datë 21.1.2015; nr. 474, datë 3.6.2015, të ndryshuara, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me numër pasurie 13/118, 3/489, 3/486, 3/490, 3/491, 305/166, 11/333 e 20/209 në drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 1 dhe Kukës të jenë, sipas lidhjes G, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me numër pasurie 8/1079, 440/776,



5/427 e 6/926 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1 të jenë, sipas lidhjes H, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me numër pasurie 8/355, 13/659 e 400/671 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1 të jenë, sipas lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ç) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me numër pasurie 178/41, 4/353, 4/198 e 7/704 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1 të jenë, sipas lidhjes J, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

d) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me numër pasurie 433/160, 1/534, 433/260 e 436/95 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1 të jenë, sipas lidhjes K, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

dh) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me numër pasurie 9/207, 24/235 e 25/315 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan të jenë, sipas lidhjes O, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

e) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me numër pasurie 1/511, 10/317 e 3/301 në drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan dhe Tërana 1 të jenë, sipas lidhjes Q, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ë) Gjenealitetet e poseduesve të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me numër pasurie 1/1087 e 3/114 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1 të jenë, sipas lidhjes R, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

f) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me numër pasurie 178/28, 26/111 e 3/707 në drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1, Kukës dhe Korçë të jenë, sipas lidhjes S, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

g) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me numër pasurie 1/458 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan të jenë, sipas lidhjes Z, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

gj) Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me numër pasurie 1/97 e 2/480 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan të jenë, sipas lidhjes AA, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

h) Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me numër pasurie 3/1063 e 3/1057 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Korçë të jenë, sipas lidhjes AE, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

i) Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me numër pasurie 101/100 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 4 të jenë, sipas lidhjes AH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

j) Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me numër pasurie 101/55/1 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 4 të jenë sipas lidhjes AJ, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Urban
Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale

LISTA EMËRORE SIPAS DREJTORIVE RAJONALE PËR KORRIGJIM

LIDHJA G									
NR. RENDOR	DREJTORIA	KORRIGJIMI	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	NR. I PROTOKOLLI I VETËDEKLARIMIT PËR LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISË	SIPËRFAQJA E PARCELËS NDËRTIMORE PËR KALIM PRONËSIE (m ²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
1	TIRANA 1	ISHTE	HAXHI	HYSEN	SULAJ	2890	8320	13/118	500.4
		BËHET	ARBEN	HAXHI	SULAJ	2889,2888	8320	13/118	500.4
2	TIRANA 1	ISHTE	ALBERT	KODHELI	SALIAJ	1069, 309	8330	3/489	462.4
		BËHET	ALBERT	KODHEL	SALIAJ	1069, 309	8330	3/489	459
3	TIRANA 1	ISHTE	SALI	KODHELI	SALIAJ	1028, 311	8330	3/486	437.7
		BËHET	DONALD	SALI	SALIAJ	1028, 311	8330	3/486	443.4
		BËHET	BUKUROSHI	MERSIN	SALIAJ				
		BËHET	DONALD	SALI	SALIAJ				
		BËHET	ERMAL	SALI	SALIAJ				
BËHET	HAVA	SALI	SALIAJ						
4	TIRANA 1	ISHTE	KODHELI	SALI	SALIAJ	1027, 310	8330	3/490	466.7
		BËHET	KODHEL	SALI	SALIAJ	1027, 310	8330	3/490	267.9
5	TIRANA 1	ISHTE	ADNAND	HAJRI	IMAMI	1026	8330	3/491	489.2
		BËHET	ADNAN	HAJRI	IMAMI	1026	8330	3/491	456
6	TIRANA 1	ISHTE	NDUE	GJOK	MEXHAJ	854,1781	8220	305/166	300.2
		BËHET	VASIL	GJOK	MEXHAJ	1781, 12_2198186	8220	305/166	300.2
7	TIRANA 1	ISHTE	ARBEN	ZYBER	DJALOSHI	1127	8310	11/333	274.5
		BËHET	ARBEN	ZYBER	DJALOSHI	1136, 12_2150044	8310	11/333	304
8	KUKËS	ISHTE	SHYQYRI	VESEL	KASTRATI	17/21	2315	20/209	498.16
		BËHET	ANULOHE						
LIDHJA H									
9	TIRANA 1	ISHTE	MARK	FRAN	BREGU	163/	8120	8/1079	173.5
		BËHET	PASHKO	FRAN	BREGU	163	8120	8/1079	173.5
		BËHET	MARK	FRAN	BREGU	163	8120	8/1079	173.5
		BËHET	PASHKO	FRAN	BREGU				
BËHET	PAVLIN	FRAN	BREGU						
10	TIRANA 1	ISHTE	FATMIR	HYSEN	DEMIRI	330	2679	440/776	397.1
		BËHET	FATMIR	HYSEN	DEMIRI	330	2679	440/776	397.1
		BËHET	AVNI	HYSEN	DEMIRI				
		BËHET	ABAS	HYSEN	DEMIRI				
		BËHET	MAKSUD	HYSEN	DEMIRI				
BËHET	MIHANE	BAJRAM	DEMIRI						
11	TIRANA 1	ISHTE	YLLI	RAMADAN	BEQO	11/1	8120	5/427	378
		BËHET	YLLI	RAMADAN	BEQO	80	8120	5/427	378
		BËHET	FATMIR	SHABAN	RIZVANI				
		BËHET	LULJETA	RAMAZAN	MNERI				
12	TIRANA 1	ISHTE	BESNIK	REXHEP	TUSHA	1677	8310	6/926	253.0
		BËHET	BESNIK	REXHEP	TUSHA	1677	8310	6/926	253.0
		BËHET	ILIR	BESNIK	TUSHA				
LIDHJA I									
13	TIRANA 1	ISHTE	AFRIM	MERSIN	VATA	594	8190	8/355	500
		BËHET	AFRIM	MERSIN	VATA	594	8190	8/355	500
		BËHET	MERSIN	ISUF	VATA				
14	TIRANA 1	ISHTE	FLUTURA	SHABAN	RAMADANI	1307	8190	13/659	359
		BËHET	FLUTURA	SHABAN	RAMADANI	1307	8190	13/659	359
		BËHET	SHABAN	SADIK	MESHI				
15	TIRANA 1	ISHTE	XHEVIT	BUJAR	HASMUCA	543	3266	400/671	349
		BËHET	XHAVIT	BAJRAM	HASMUCA	543	3266	174/671	349
LIDHJA J									
16	TIRANA 1	ISHTE	NAZIE	NAJTI	MUÇINA	718	2460	178/41	261
		BËHET	NAZIE	NAJTI	MUÇINA	718	2460	496/41	261
		BËHET	FISNIK	KAMBER	MUÇINA				
17	TIRANA 1	ISHTE	ARBEN	PJETER	ÇOKAJ	965	8310	4/353	300
		BËHET	PJETER	ADEM	ÇOKAJ				
		BËHET	ARBEN	PJETER	ÇOKAJ	965	8310	4/353	234.4
		BËHET	PJETER	ADEM	ÇOKAJ				
18	TIRANA 1	ISHTE	GEZIM	PJETER	ÇOKAJ	1026	8310	4/198	389
		BËHET	GEZIM	PJETER	ÇOKAJ	1026	8310	4/198	321.8
19	TIRANA 1	ISHTE	QEMAL	BEQIR	NUHILLARI	223	8190	7/704	333
		BËHET	SAJMIR	QEMAL	NUHILLARI	223	8190	7/704	406.1
LIDHJA K									
20	TIRANA 1	ISHTE	MITAT	BANUSH	HIMA	1948,166	3866	433/160	177



		BËHET	MITAT	BANUSH	HIME	1948,166	3866	436/160	185.3
21	TIRANA 1	ISHTE	DOLOR	IZET	SELIMI	2606	8240	1/534	210.8
		BËHET	DOLOR	IZAET	SELIMI	2606	8240	1/534	245.5
22	TIRANA 1	ISHTE	ESTAT	XHEMAL	HYSENJI	18,2091	3321	433/260	497
		BËHET	ESAT	XHEMAL	HYSENJI	18,2091	3321	433/260	497
23	TIRANA 1	ISHTE	PETRIT	IBRAHIM	GJOSHI	1693	3866	436/95	372
		BËHET	PETRIT	IBRAHIM	GJOSHI	1693	3866	436/95	372
LIDHJA O									
24	ELBASAN	Ishte	VENEMIN	JORGJI	DEDJA	7230	8523	9/207	31.7
		Bëhet	VENEMIN	JORGJI	DEDJA	7230	8523	9/252	31.7
25	ELBASAN	Ishte	BUKURIE	KURI	DEDJA	8474	8523	24/235	233.7
		Bëhet	PETRAQ	JORGJI	DEDJA	8474	8523	24/235	233.7
26	ELBASAN	Ishte	GAZMIR	IDRIZ	LAMI	8473	8523	25/315	99.9
		Bëhet	MERITA	GAZMIR	SHUKULLANJI	8473	8523	25/315	99.9
LIDHJA Q									
27	ELBASAN	Ishte	HAMDI	SHEFQET	SULAJ	5225	8523	25/312	99.9
		Bëhet	HAMDI	SHEFQET	SULAJ	6815	8523	25/312	99.9
28	ELBASAN	Ishte	ISMAIL	BAJRAM	HALA	1313	2446	1/511	32.9
		Bëhet	ESAD	RAMIZ	KACA	784	2446	1/511	78.5
29	TIRANA 1	Ishte	TEFIK	FERIT	TANUSHI	996	8210	3/301	104
		Bëhet	ISMAIL	BAJRAM	HALA	1313, 21426	8210	3/301	218.6
30	TIRANA 1	Ishte	NURIE	MUSA	HALA	784	8210	3/301	104
		Bëhet	ESAD	RAMIZ	KACA	996	8210	3/301	218.6
31	TIRANA 1	Ishte	TEFIK	FERIT	TANUSHI	996	8210	3/301	104
		Bëhet	SONELA	BASHKIM	ARIFI	266	8210	3/301	104
LIDHJA R									
32	TIRANA 1	Ishte	AUREL	BASHKIM	ARIFI	266,26,2203299	8210	3/301	218.6
		Bëhet	XHEVAT	QANI	GEGA	832	2446	10/317	21.6
33	TIRANA 1	Ishte	XHEVAT	QANI	GEGA	832	2446	10/317	30.7
		Bëhet	SONELA	BASHKIM	ARIFI	266	8210	3/301	104
34	TIRANA 1	Ishte	AUREL	BASHKIM	ARIFI	266,26,2203299	8210	3/301	218.6
		Bëhet	SONELA	BASHKIM	ARIFI	266,26,2203299	8210	3/301	218.6
LIDHJA S									
35	TIRANA 1	Ishte	BEŞJAN	IMER	SHEHU	488	8330	1/1087	19
		Bëhet	BEŞJAN	IMER	SHEHI	488, 12_2011519	8330	1/1087	42.5
36	TIRANA 1	Ishte	GJINOVEFA	SINAN	MALI	281	8370	3/114	56
		Bëhet	GJINOVEFA	SINAN	MALI	281	8370	3/114	82
37	TIRANA 1	Ishte	ARTAN	MEHMET	MALI	281	8370	3/114	82
		Bëhet	MIRELA	MEHMET	MALI	281	8370	3/114	82
LIDHJA T									
38	TIRANA 1	Ishte	LLUKAN	PETRO	TEKA	25	2460	178/28	292
		Bëhet	LLUKAN	PETRO	TEKA	25	2460	496/28	292
39	KUKËS	Ishte	ILIR	LLUKAN	TEKA	25	2460	496/28	292
		Bëhet	PERPARIM	MALIQ	ELEZI	3/01	2315	26/111	44.44
40	KUKËS	Ishte	PERPARIM	MALIQ	ELEZI	3/01; 219	2315	26/111/1	148.68
		Bëhet	PERPARIM	MALIQ	ELEZI	3/01; 219	2315	26/111/1	148.68
41	KORÇË	Ishte	ANESTI	DHIMITRI	FURXHI	A1-292	8563	3/707	103.63
		Bëhet	BAJRAM	GANI	MICANI	A1-292	8563	3/707	103.63
42	KORÇË	Ishte	PETRAQ	THIMI	FOTO	A1-292	8563	3/707	103.63
		Bëhet	MYZAFER	NEIM	HAXHI	A1-292	8563	3/707	103.63
43	KORÇË	Ishte	VIRION	MERSIN	LALOLLARI	A1-292	8563	3/707	103.63
		Bëhet	BAJRAM	GANI	MICANI	A1-292	8563	3/707	103.63
44	KORÇË	Ishte	ANESTI	DHIMITRI	FURXHI	A1-292	8563	3/707	103.63
		Bëhet	VIRION	MERSIN	LALOLLARI	A1-292	8563	3/707	103.63
45	KORÇË	Ishte	MYZAFER	NEIM	HAXHI	A1-292	8563	3/707	103.63
		Bëhet	PETRAQ	THIMI	FOTO	A1-292	8563	3/707	103.63
LIDHJA U									
46	ELBASAN	Ishte	HARUN	HAXHI	PELLUMBI	236	2924	1/458	296.9
		Bëhet	KRISTO	HAXHI	PELLUMBI	236	2924	1/458	296.9
47	ELBASAN	Ishte	FATMIR	BAJRAM	DADA	13888	2924	1/458	296.9
		Bëhet	FATMIR	BAJRAM	DADA	13888	2924	1/458	296.9
LIDHJA V									
48	ELBASAN	Ishte	ZEQIR	ISMAL	SLAMI	4178	8525	1/97	70.1
		Bëhet	ZEQIR	ISMAL	SLAMI	4178, 8516	8525	1/97	140
49	ELBASAN	Ishte	JANI	XHEVAT	TORRA	336	2954	2/480	23.58
		Bëhet	MINE	QAMIL	DIKO	233	2954	2/480	23.58
50	ELBASAN	Ishte	JANI	XHEVAT	TORA	336	2924	2/480	23.6
		Bëhet	MINE	QAMIL	DIKO	233	2924	2/480	23.6
51	ELBASAN	Ishte	FAIK	QAMIL	BALLA	1200, 21302	2924	2/480	23.6
		Bëhet	PETRIT	XHELO	ALLA	21305	2924	2/480	23.6
52	ELBASAN	Ishte	NAIM	XHEMAL	MEKSHI	1199, 21303	2924	2/480	23.6
		Bëhet	NAIM	XHEMAL	MEKSHI	1199, 21303	2924	2/480	23.6
LIDHJA X									
53	KORÇË	Ishte	PIRO	DHORI	KOTA	A1-731	8561	3/1063	16.6
		Bëhet	PIRO	DHORI	KOTA	A1-731	8561	3/1113	16.1
54	KORÇË	Ishte	MARIKA	STAVRI	KOTA	A1-731	8561	3/1113	16.1
		Bëhet	MARIKA	STAVRI	KOTA	A1-731	8561	3/1113	16.1
55	KORÇË	Ishte	XHOXHI	THOMA	XHOGA	A1-627	8561	3/1057	6.6
		Bëhet	XHOXHI	THOMA	XHOGA	A1-627	8561	3/1057	6.6
56	KORÇË	Ishte	SOFOKLI	XHOXHI	XHOGA	A1-627	8561	3/1057	6.6
		Bëhet	SOFOKLI	XHOXHI	XHOGA	A1-627	8561	3/1057	6.6



								3/1057	
LIDHJA AH									
40	TIRANA 4	ISHTE	KRENAR	KADRI	BIZHGA	828	1791	101/100	500
ANULLOHET									
LIDHJA AJ									
41	TIRANA 4	ISHTE	KRENAR	KADRI	BIZHGA	828	1791	101/55/1	500
		BËHET	KRENAR	KADRI	BIZHGA	828	1791	101/55/1	462,1

VENDIM
Nr. 956, datë 25.11.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 283, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E TIPAVE, RREGULLAVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE NË TOKË BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 5/2 e 5/4, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1, e kreut IV, të vendimit nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 957, datë 25.11.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR NIVELET UDHËZUESE TË PËRQENDRIMIT TË RADONIT NË MJEDISET E BRENDSSHME DHE PËRQENDRIMET E RADIOBËRTHAMAVE NË MALLRA, ME EFEKT MBROJTJEN E PUBLIKUT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit 1, të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet

jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për nivelet udhëzuese të përqendrimit të radonit në mjediset e brendshme dhe përqendrimit e radiobërthamave në mallra, me efekt mbrojtjen e publikut”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 591, datë 18.8.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore “Për nivelet e lejuara të përqendrimit të radonit në ndërtesa dhe ujë, nivelet udhëzuese të radiobërthamave në materialet e ndërtimit, si dhe nivelet e lejuara të radiobërthamave në ushqime dhe produkte kozmetike””, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe të gjitha institucionet e përmendura në rregullore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR NIVELET UDHËZUESE TË PËRQENDRIMIT TË RADONIT NË MJEDISET E BRENDSSHME DHE PËRQENDRIMET E RADIOBËRTHAMAVE NË MALLRA, ME EFEKT MBROJTJEN E PUBLIKUT

Neni 1

Objektivi i rregullore

Objektivi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i niveleve të referencës për përqendrimin e radonit në vendet e punës e godinat e banimit dhe për përqendrimin e radiobërthamave në ujë të destinuar për konsum publik, materiale ndërtimi, skrape, në produktet ushqimore, ushqimet për kafshët dhe produktet kozmetike të kontaminuara si rezultat i një aksidenti bërthamor apo emergjence radiologjike, si dhe për të marrë masa kontrolli për



të siguruar mbrojtjen e publikut e të mjedisit nga efektet e dëmshme të rrezatimit jonizues.

Neni 2 Përcaktimet

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Produkt bujqësor”, çdo prodhim ushqimor për konsum njerëzor dhe ushqim për kafshët;

b) “Material ndërtimi”, çdo material i cili vendoset në mënyrë të përhershme në një ndërtesë ose pjesët e saj, prania e të cilit ka efekt në ekspozimin e publikut nga rrezatimet jonizuese;

c) “Ngarkesë”, sasia e çdo produkti, pjesë e të njëjtit dokument, i transportuar me të njëjtën mënyrë transporti dhe që vjen nga i njëjti vend origjine;

ç) “Produkt kozmetik”, çdo substancë ose përzjerje substancash e destinuar për t’u vendosur në kontakt me pjesë të ndryshme të trupit të njeriut (epidermë, flokë, thonj, buzë dhe organe gjenitale të jashtme) ose me dhëmbët dhe mukozat e membranave të kavitetëve orale për pastrimin, aromatizimin e tyre, ndryshimin e pamjes ose ndryshimin e aromës së trupit dhe/ose mbrojtjen e mbajtjen e tyre në kushte të mira;

d) “Ushqimi”, produkt i cili është i destinuar për konsum njerëzor si material bazë ose i përpunuar;

dh) “Ushqimi për kafshët”, produkt i cili është i destinuar vetëm për ushqimin e kafshëve;

e) “Burim i humbur”, një burim radioaktiv i cili nuk është as i përjashtuar, por as nën kontrollin rregullator, sepse ai kurrë nuk ka qenë nën kontrollin rregullator ose/sepse ka qenë i braktisur, i humbur, i zhvendosur, i vjedhur ose i transferuar pa autorizimin e duhur;

ë) “Radon”, radiobërthama Rn-222, si dhe pasardhësit e tij në familje;

f) “Masë përmirësuese”, largimi i burimit radioaktiv, kufizimi i aktivitetit, ndërprerja e rrugëve të ekspozimit, zvogëlimi i ndikimit të tyre me qëllim ndalimin ose zvogëlimin e dozës, që mund të merret në një situatë ekspozimi ekzistuese;

g) “Nivel reference”, niveli i dozës efektive ose i dozës ekuivalente apo përqendrimi i aktivitetit mbi të cilin është gjykuar si e papërshtatshme të lejohen ekspozime, edhe pse ky nuk është një limit që nuk mund të tejkalohet;

gj) “Ujë i destinuar për konsum njerëzor”, është:

i) uji në gjendjen e tij natyrale ose pas trajtimit, i destinuar për t’u pirë, për gatim, përgatitje ushqimi ose qëllime të tjera shtëpiake, pa marrë parasysh origjinën e tij, nëse vjen nga një rrjet furnizimi, një cisternë, shishe ose depozita;

ii) uji që përdoret në industrinë ushqimore me qëllim për të prodhuar, përpunuar, ruajtur apo tregtuar produkte ose substanca për konsum njerëzor, derisa autoriteti kombëtar kompetent është i sigurt që cilësia e ujit nuk mund të ndikojë në vlerat ushqimore të produktit përfundimtar.

PJESA I

NIVELI UDHËZUES PËR PËRQENDRIMIN E RADONIT NË MJEDISËT E BRENDSHME

Neni 3

Plani i veprimit për radonin

1. Institucionet kombëtare, nën kryesimin e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR), të cilit i referohemi, hartojnë programin kombëtar për rreziqet afatgjata nga ekspozimi i radonit në banesa, godina publike dhe vendet e punës.

2. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ), të cilit i referohemi, dhe institucione të tjera identifikojnë zonat ku përqendrimi i radonit (i konvertuar në dozë mesatare vjetore) për një numër të konsiderueshëm mjedisesh pritet të kalojë nivelet udhëzuese që jepen në nenet 4 dhe 5, të kësaj rregulloreje. Ky informacion i dërgohet Zyres së Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) në rrugë zyrtare.

3. Radoni në ndërtimet e reja nuk duhet të kalojë nivelet udhëzuese që jepen në nenet 4 dhe 5, të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Përqendrimi i radonit në vendet e punës

1. Përqendrimi mesatar vjetor i radonit në mjediset e brendshme të vendeve të punës nuk duhet të kalojë 300 Bq/m³.

2. Me qëllim kontrollimin e përputhshmërisë së vlerës udhëzuese të përcaktuar në pikën 1, matjet e radonit duhet të kryhen nga persona fizikë apo juridikë të njohur nga ana e KMR-së. Matjet e radonit kryhen në vendet e punës, si më poshtë:

a) Vendet e punës nëntokësore, ku përfshihen minierat, tunelet, lixhat, instalimet nëntokësore, katakombet, shpellat dhe guvat turistike, stacionet nëntokësore të ruajtjes dhe të përpunimit të ujit;



b) Vendet e punës mbitokësore, ku përfshihen fabrikat, magazinat, dyqanet ose vendet e tjera të punës ku përdoren, përpunohen ose ruhen lëndët e para me përqendrim të lartë të Ra-226;

c) Çdo vend pune tjetër për të cilin KMR-ja ka arsye të besojë se publiku ose punonjësit janë të ekspozuar ndaj përqendrimeve të larta të radonit.

3. Personat fizikë ose juridikë paraqesin pranë KMR-së metodologjinë për kryerjen e matjeve.

4. Në rast se rezultatet e matjeve të kryera në përputhje me pikën 2 tregojnë një përqendrim mesatar vjetor të radonit në vendet e punës më të lartë se $300\text{Bq}/\text{m}^3$, personi i njohur për kryerjen e veprimtarisë duhet të marrë masa në vendet e punës për të zvogëluar përqendrimin e radonit, në të cilat përfshihen:

- a) kufizimi i kohës së ekspozimit;
- b) kontrolli i hyrjeve;
- c) monitorimi i vendit të punës;
- ç) ventilimi;
- d) masa mbrojtëse respiratore;

dh) masa inxhinierike të godinës për të zvogëluar hyrjen e gazit radon.

Pas përmirësimit të kryhet një rivlerësim i përqendrimit të radonit në vendet e punës.

5. Në rastin kur, megjithëse janë marrë të gjitha masat në përputhje me pikën 3, përqendrimi mesatar i radonit vazhdon të kalojë $300\text{Bq}/\text{m}^3$, personat e njohur që ushtrojnë aktivitetin njoftojnë KMR-në, e cila vendos për masat e mbrojtjes nga rrezatimi jonizues në përputhje me rregulloren nr. 590, datë 18.8.2011, “Për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese” dhe rregulloren nr. 10, datë 7.1.2010, “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”.

Neni 5

Përqendrimi i radonit në ndërtesat e banimit dhe godinat publike

1. Përqendrimi mesatar vjetor i radonit në mjedisin e brendshëm të ndërtesave të banimit dhe godinave publike nuk duhet të kalojë $300\text{Bq}/\text{m}^3$.

2. Me qëllim kontrollin e përputhshmërisë së përqendrimit të radonit në ndërtesat e banimit dhe godinat publike me vlerat udhëzuese të dhëna në pikën 1, të këtij neni, matjet e përqendrimit të radonit kryhen nga Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ-ja) dhe institucione të tjera të njohura nga KMR-ja.

3. Institucionet përgjegjëse për matjet e radonit duhet të paraqesin në KMR metodologjinë e kryerjes së matjeve.

4. Në ato mjedise ku përqendrimi mesatar vjetor i radonit është gjetur më i lartë se $300\text{Bq}/\text{m}^3$, pronarët e ndërtesave të banimit duhet të marrin masat e duhura për të zvogëluar përqendrimin e radonit.

5. Në rastin e ndërtesave të banimit, KMR-ja informon publikun për shkallën e përqendrimit të radonit në mjediset e brendshme, rrezikun në shëndet, për rëndësinë e kryerjes së matjeve dhe masave mbrojtëse, që ndikojnë në zvogëlimin e përqendrimit të radonit.

6. Në rastin e godinave publike, KMR-ja ka të drejtën të zbatojë sanksione për zbatimin e masave përmirësuese.

PJESA II

Neni 6

Nivelet udhëzuese për radiobërthamat në ujin për konsum publik

1. Përqendrimi i radonit në ujin për konsum publik nuk duhet të kalojë vlerën $100\text{Bq}/\text{l}$.

2. Përqendrimi i tritiumit në ujin për konsum publik nuk duhet të kalojë vlerën $100\text{Bq}/\text{l}$.

3. Përqendrimi i të gjitha radiobërthamave të zbuluara në furnizuesit e ujit për konsum publik, përjashtuar tritium, kalium-40, radon dhe produktet me periudhë të shkurtër gjysmëzbërthimi duhet të jenë të tilla që doza efektive e shkaktuar në një vit të mos kalojë 0.1mSv .

Neni 7

Monitorimi i përputhshmërisë

1. Për të kontrolluar përputhshmërinë e niveleve udhëzuese të përcaktuara në nenin 6, monitorimi i ujit i destinuar për konsum publik duhet të kryhet në bazë të metodikave të miratuara nga KMR-ja.

2. Monitorimi i ujit i destinuar për konsum publik duhet të kryhet në pikat e mëposhtme:

a) Në rastin e ujit që vjen nga rrjeti i shpërndarjes, uji monitorohet në pikën kur del nga rubineti;

b) Në rastin e ujit që vjen me cisterna, uji monitorohet në pikën kur del prej saj;



c) Në rastin e ujit të ambalazhuar në shishe ose enë të destinuar për shitje, uji monitorohet në pikën ku mbushen shishet dhe enët;

ç) Në rastin e ujit të përdorur në një njësi prodhimi ushqimor, uji monitorohet në pikën ku përdoret.

3. Monitorimi i ujit të destinuar për konsum publik kryhet nga IFBZ-ja ose institucione të tjera të njohura nga KMR-ja.

Neni 8

Mospërputhshmëria

1. Në rast se rezultatet e monitorimit të kryer në përputhje me nenin 7 tregojnë se përqendrimit e radiobërthamave i kalojnë nivelet e referencës të dhëna në nenin 6, personi që ka kryer monitorimin duhet të zbulojë shkaku dhe mospërputhshmërisë dhe duhet të njoftojë KMR-në.

2. Në raste të tilla siç referohen në pikën 1 të këtij neni, KMR-ja duhet të vlerësojë nëse kjo mospërputhje përbën një rrezik për shëndetin e njeriut dhe nëse duhet të merren masa.

3. Në rast se KMR-ja vlerëson se rreziku referuar në pikën 2, të këtij neni, është real, KMR-ja:

a) vendos të merren masa përmirësuese në përputhje me kërkesat e mbrojtjes së shëndetit të njeriut nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi.

b) siguron që publiku:

- të informohet për rrezikun dhe masat përmirësuese të nevojshme;

- të këshillohet për ndonjë masë paraprake shtesë që mund të nevojitet për mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga materialet radioaktive.

Neni 9

Përrjashtimet

1. Përcaktimet e neneve 6, 7 dhe 8 nuk aplikohen për:

a) ujërat minerale natyrale;

b) ujërat e përcaktuara si produkte mjekësore.

2. Uji i destinuar për konsum publik nga një furnizues individual që siguron mesatarisht më pak se 10m³ në ditë ose që shërben për më pak se 50 persona përjashtohet nga parashikimet e neneve 6, 7 dhe 8.

PJESA III

NIVELET E REFERENCËS PËR PRODUKTET BUJQËSORE TË KONTAMINUARA SI REZULTAT I NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR OSE EMERGJENCE RADIOLOGJIKE

Neni 10

Nivelet e lejuara maksimale për ushqimet e kontaminuara me substanca radioaktive

1. Ndërfutja e qëllimshme e substancave radioaktive në prodhimin e ushqimeve është e ndaluar, si edhe import-eksporti i tyre.

2. Nivelet e lejuara maksimale nga kontaminimi radioaktiv i produkteve ushqimore si rezultat i një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike janë përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Nivelet e lejuara maksimale të kontaminimit radioaktiv për ushqimet e kafshëve

1. Futja e qëllimshme e substancave radioaktive në prodhimin e ushqimit për kafshë është e ndaluar, si edhe import-eksporti i tyre.

2. Nivelet e lejuara maksimale nga kontaminimi radioaktiv i ushqimit për kafshë si rezultat i një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike janë dhënë në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Nivelet e lejuara maksimale të kontaminimit radioaktiv për produktet e kozmetikës

1. Futja e qëllimshme e substancave radioaktive në prodhimin e produkteve kozmetike është e ndaluar, si dhe import-eksporti i tyre.

2. Nivelet e lejuara maksimale nga kontaminimi radioaktiv i produkteve kozmetike nga kontaminimi i një ose më shumë përbërësve të listuar në tabelën 2 të shtojcës 1, duhet të nxirren nga nivelet e lejuara maksimale që janë dhënë në tabelën 1 të shtojcës 1. Në rast se produktet kozmetike nuk përfshihen ose nuk janë pjesë përbërëse e elementeve të listuara në tabelën 2, nivelet e lejuara maksimale merren duke iu referuar kolonës së fundit për produktet ushqimore të tjera.



Neni 13

Rishikimi i niveleve të lejuara maksimale

Nivelet e lejuara maksimale të përcaktuara në shtojcat 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje mund të kufizohen përkohësisht, të plotësohen ose të rishikohen, me propozim të KMR-së, në varësi të rrethanave të veçanta, në rast të një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike.

Neni 14

Kontrolli i importeve

1. Produktet bujqësore të importuara nga vendet e prekura nga një aksident bërthamor ose emergjencë radiologjike do të dalin në treg vetëm nëse këto produkte u nënshtrohen procedurave doganore në territorin e doganës së Republikës së Shqipërisë, në përputhje me “Udhëzuesin e procedurave për lëvizjen fizike të materialeve radioaktive, mallrave dhe reagimit në rast incidenti me burime radioaktive në pikat doganore”, i miratuar në bazë të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar.

2. Procedura e kontrollit në pikat e kontrollit kufitar referuar në pikën 1, të këtij neni, konsiston në kontrollin e dokumentacionit, identitetit dhe kontrollin fizik, duke përfshirë marrjen e mostrave dhe analizat laboratorike të radiobërthamave në pika kufitare hyrëse, siç janë specifikuar në shtojcat 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje. Kontrolli i tyre bëhet nga AKU-ja. Produktet ushqimore duhet të jenë të shoqëruara me raport analize në lidhje me përmbajtjen e përqendrimit të radiobërthamave. Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave civile njofton AKU-në në rast aksidenti bërthamor ose radiologjik.

3. Produktet, që nuk përmbushin kërkesat e kësaj rregulloreje, nuk do të dalin në treg dhe do të depozitohen në mënyrë të sigurt ose do të kthehen në vendin e origjinës.

4. Të gjitha shpenzimet që rezultojnë nga kontrollet zyrtare të referuara në pikën 2, të këtij neni, si dhe të gjitha masat që merren në vijim nga mospërmbushja e kërkesave, siç specifikohet në pikën 3, të këtij neni, do të përballohen nga importuesi.

Neni 15

Kontrolli i eksporteve

1. Eksporti i produkteve bujqësore të kontaminuara si rezultat i një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike lejohet vetëm nëse eksportuesi do të demonstrojë nëpërmjet matjeve të dokumentuara në certifikatën e eksportit se respektohen nivelet e lejuara maksimale të përcaktuara në shtojcat 1 dhe 2 ose se janë në përputhje me nenin 13 të kësaj rregulloreje.

2. Certifikata e eksportit referuar pikës 1, të këtij neni, plotësohet duke përdorur modelin e dhënë në shtojcën 3.

3. Certifikata e eksportit referuar pikës 1, të këtij neni, shoqëron çdo ngarkesë produkti.

4. Certifikata e eksportit lëshohet nga persona fizikë ose juridikë, të njohur nga KMR-ja, në përputhje me udhëzuesin e miratuar për këtë qëllim, në bazë të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar.

PJESA IV

Neni 16

Nivelet e referencës së rrezatimit gama të emetuar nga materialet e ndërtimit

Ekspozimi i jashtëm në mjediset e brendshme të rrezatimit gama, i emetuar nga materialet e ndërtimit, do të kufizohet në 1 mSv në vit, në shtesë të ekspozimit të jashtëm në mjediset e jashtme.

Neni 17

Kontrolli i materialeve të ndërtimit

Çdo person fizik dhe juridik që ka për qëllim të nxjerrë në treg, përfshirë edhe import-eksportin, materialet e ndërtimit sipas llojeve të specifikuara në shtojcën 4 të kësaj rregulloreje:

a) përcakton përqendrimin e aktivitetit të radiobërthamave të specifikuara në shtojcën 5 të kësaj rregulloreje;

b) informon KMR-në për rezultatet e matjeve dhe përqendrimin e aktivitetit të indeksuar të radiobërthamave, siç është përcaktuar në shtojcën 5 të kësaj rregulloreje.



Neni 18

Tregtimi i materialeve të ndërtimit

1. Në qoftë se shuma e aktiviteteve të indeksuara të një materiali ndërtimi nuk e kalon vlerën 1, materiali mund të nxirret në treg dhe të përdoret për qëllime ndërtimi pa asnjë kufizim lidhur me aktivitetin e tij.

2. Në qoftë se shuma e aktiviteteve të indeksuara të një materiali ndërtimi kalon vlerën 1, materiali mund të dalë në treg vetëm nëse shitësi demonstron përputhjen me nenin 16 të kësaj rregulloreje.

3. Materialet e ndërtimit, të cilat tejkalojnë nivelet e referencës të dhëna në nenin 16, mund të dalin në treg vetëm nën masa të përshtatshme sigurie, të cilat do të përcaktohen nga KMR-ja sipas rastit.

Neni 19

Importi dhe eksporti i materialeve të ndërtimit

Të gjitha import-eksportet e materialeve të ndërtimit të listuara në shtojcën 4 duhen të kenë të përfshira në specifikimet teknike të materialeve vlerën e përqendrimit të aktivitetit të indeksuar, të llogaritur në përputhje me shtojcën 5, ose deklaratën e përjashtimit bazuar në llogaritjen e dozës në përputhje me nenin 18/2.

PJESA V

Neni 20

Kontrolli i skrapeve

1. Të gjitha qendrat e mëdha të grumbullimit të skrapit dhe instalimet e mëdha të riciklimit të skrapit, si edhe nyjat e rëndësishme të transitit të pajisen me sisteme dedektimi pasive të përshtatshme, të afta për të zbuluar praninë e burimeve radioaktive ose skrapeve të kontaminuara.

2. Personat fizikë dhe juridikë, përgjegjës për objektet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, të marrin masat e nevojshme për të siguruar këshillim dhe asistencë teknike të specializuar në rastin e zbulimit të një burimi jetim ose skrapit të kontaminuar me radioaktivitet, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e punëtorëve dhe publikut nga rrezatimi, si dhe të bëhet sigurimi i burimit në mjediset e përshtatshme.

3. Në rastin e zbulimit të një burimi jetim ose skrapit të kontaminuar me radioaktivitet, personat

fizikë dhe juridikë, përgjegjës për objektet e përmendura në pikën 1 këtij neni, të njoftojnë menjëherë KMR-në.

Neni 21

Dispozita të veçanta për instalimet e riciklimit të skrapit

1. Pa rënë ndesh me nenin 20, personat fizikë dhe juridikë, përgjegjës për instalimet e riciklimit të skrapit, të njoftojnë menjëherë KMR-në në qoftë se ata dyshojnë për ndonjë shkrirje ose veprim tjetër metalurgjik, me burim jetim ose skrap të kontaminuar me radioaktivitet.

2. Materialet e kontaminuara që rezultojnë nga shkrirja e burimeve radioaktive ose materialeve të kontaminuara nuk do të përdoren dhe nuk do të dalin në treg. Këto lëndë të përpunuara mund të depozitohen në vende të sigurta me miratimin e KMR-së. Për përpunimin e mëtejshëm të tyre duhet të merren lejet përkatëse në KMR.

3. Të gjitha pajisjet e përdorura për detektim të skrapeve të kontaminuara duhet të jenë të testuara dhe të kalibruara.

Neni 22

Informacion për punëmarrësit lidhur me skrapet

1. Personat fizikë dhe juridikë, përgjegjës për objektet e përmendura në nenin 20, informojnë punëmarrësit e tyre në lidhje me mundësinë për t'u përballur me burime jetime apo skrape të kontaminuara me lëndë radioaktive.

2. Punëmarrësit, të cilët mund të përballen me burime jetime ose skrape të kontaminuara me lëndë radioaktive, duhet:

a) të trajnohen në zbulimin vizual të burimeve radioaktive dhe kontejnerëve të tyre;

b) të kenë njohuritë dhe informacionin bazë për rrezatimin jonizues dhe efektet e tij;

c) të trajnohen për përdorimin e sistemeve të zbulimit;

ç) të informohen dhe të trajnohen për veprimet që ndërmerren në terren në rast të zbulimit të një burimi jetim apo skrapit të kontaminuar me lëndë radioaktive.

Neni 23

Importi dhe eksporti i skrapeve

1. Çdo person fizik ose juridik, që ka për qëllim të eksportoje skrap, siguron monitorimin e



rrezatimit të skrapit dhe provon nëpërmjet një certifikate pastërtie që skrapit nuk është i kontaminuar me lëndë radioaktive.

2. Monitorimi i skrapit kryhet përpara se ngarkesa të largohet nga mjediset e furnizuesit.

3. Certifikata e pastërtisë së dërgesës referuar pikës 1, të këtij neni, hartohet duke përdorur formularin e dhënë në shtojcën 6 të kësaj rregulloreje dhe kjo do t'i bashkëngjitet dokumentacionit të ngarkesës së furnizuesit.

4. Çdo person fizik ose juridik, që kërkon të importojë skrap, siguron se materiali që pritet të pranohet nuk është i kontaminuar me lëndë radioaktive, duke kërkuar një certifikatë të pastërtisë të dërgesës nga shitësi.

PJESA VI DISPOZITA TË TJERA

Neni 24

Kontrolli i cilësisë

1. Të gjitha matjet e nevojshme, që kryhen për të verifikuar përputhjen me nivelet e përcaktuara në

këtë rregullore, të bëhen me dedektorë të përshtatshëm dhe pajisje të kalibruara, të cilat u janë nënshtruar programeve të miratuara të sigurimit të cilësisë.

2. Matjet e specifikuar në nenet 4/2, 5/2, 7/1, 14/2, 15/1 dhe 17/a, kryhen nga institucione të njohura nga KMR-ja, në bazë të kriterëve të kompetencës.

3. Të gjithë laboratorët ku mostrat janë analizuar për qëllime të verifikimit të përputhshmërisë me nivelet e përcaktuara në këtë rregullore të kenë një sistem analitik të kontrollit të cilësisë.

4. Programet e monitorimit dhe metodat e matjes, të cilat do të përdoren për të verifikuar përputhshmërinë me nivelet në këto rregullore, miratohen nga KMR-ja.

5. KMR-ja inspekton zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA 1

NIVELET E LEJUARA MAKSIMALE TË KONTAMINIMIT RADIOAKTIV TË PRODUKTEVE USHQIMORE PAS NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR OSE NJË EMERGJENCE RADIOLOGJIKE

Tabela 1. Nivelet e lejuara maksimale të kontaminimit radioaktiv të produkteve ushqimore pas një aksidenti bërthamor ose një emergjence radiologjike

	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/kg or Bq/l) në produktet ushqimore ¹				
	Ushqim për bebe ²	Qumështi dhe produktet e tij ³	Produkte ushqimore të lëngshme ⁴	Produkte ushqimore të thata ⁵	Produkte ushqimore të tjera
Izotopet e stroncium-it, veçanërisht Sr-90	75	125	125	7500	750
Izotopet e jodit, veçanërisht I-131	150	500	500	20000	2.000
Izotopet Alfa emetues të plutonit dhe elementet e familjes së plutonit, veçanërisht Pu-239, Am-241	1	20	20	800	80
Të gjitha bërthamat e tjera me periode gjysmëzbërthimi më të madhe se 10 ditë (përveç C-14 dhe H-3), veçanërisht Cs-134 dhe Cs-137	400	1.000	1.000	12.500	1.250

Shënime

1. Për produktet ushqimore të thata ose të përqendruara, niveli duhet të llogaritet në bazë të produktit të përpunuar gati për konsum.

2. Ushqime për bebe janë ushqimet e destinuar për ushqyerje të veçantë të fëmijëve gjatë 4 deri 6 muajve të parë të jetës. Këto ushqime plotësojnë të gjitha kërkesat e vlerave ushqimore për këtë kategori dhe janë vendosur në paketime për shitje me pakicë dhe me etiketa të qarta "ushqim i përgatitur për fëmijë".

3. Produktet për të gjitha llojet e qumështit.



4. Produktet ushqimore të lëngshme.
5. Produktet ushqimore të thata janë përcaktuar në tabelën 2.

Tabela 2. Lista e produkteve të thata

Përshkrimi
Hudhra (e freskët ose e thatë)
Kërpudha (e freskët ose e thatë)
Kërpudha (të thata, të plota, të prera, të thyera, pluhur, por jo të përpunuara)
Salep, karcof i Jeruzalemit, patate e ëmbël dhe rrënjë të ngjashme ose zhardhokë me përmbajtje të lartë niseshteje ose inuline, të freskëta ose të thata, të prera me feta ose në formë të rrumbullakët; miell palme
Lëkurat e agrumeve ose pjepri (përfshirë shalqi), të freskëta, të ngrira, të thara apo të ruajtura përkohësisht në ujë me kripë, në ujë sulfur apo në solucione të tjera ruajtëse/konservuese
Piper, fruta të thata ose të shtypura të gjinisë
Vanilje
Kanellë dhe lule e pemës së kanellës
Karafili
Fara anise, kopër, koriandër, qimnon/kumin, manaferra ose frutat e dëllinjave
Xhinxher, shafra, trumzë dhe erëza të tjera
Miell, miell palme, rrënjë ose zhardhokë të kreut nr. 0174
Niseshte
Bimë dhe pjesë të bimës (duke përfshirë farat dhe frutat), llojet e të cilave përdoren kryesisht në parfumeri, në farmaceutikë, si: insekticide, fungicide ose për qëllime të ngjashme. Këto përdoren të freskëta ose të thata, të prera ose jo, të grimcuara ose pluhur
Çdo produkt kozmetik
Gomë natyrale, rezinë, rezinë-gomë dhe balsamet
Ekstrakte dhe tretësira (lëngje) bimore/vegjetale, substancë pektike, pektina dhe pektate, agar-agar dhe lëndë të tjera ngjitëse ose trashëse, nëse janë të modifikuara ose jo, që rrjedhin nga produkte bimore
Yndyrnat, vajrat dhe fraksionet e tyre që nxirren nga peshku ose gjitarët detarë, nëse janë ose jo të rafinuar, por jo të modifikuar kimikisht
Kaviari dhe zëvendësuesit e kaviarit
Farat/fasulet e kakaos, e tërë ose e thyer, e papërpunuar ose e pjekur
Guaska/lëvozhga e kakaos, lëkura dhe mbeturina/pjesë të tjera të kakaos
Pastë kakao, nëse është ose jo e yndyrosur
Kërpudha (të përgatitura ose të ruajtura, ku përjashtohen ato në uthull dhe acid acetik)
Frutat, arrat, lëvoret e frutave dhe pjesët e tjera të bimëve, të ruajtura në sheqer (të thara, të sheqerosura ose të kristalizuara)
Majatë (aktive ose joaktive); mikroorganizmat e tjerë njëqelizorë, të vdekur; (por nuk përfshihen vaksinat e kreut nr. 3302); pudër majaje e përgatitur për pjekje
Provitaminat dhe vitaminat, natyrale apo të riprodhuara me anë të sintezës (përfshirë koncentre natyrore), derivatet e përdorura kryesisht si vitamina dhe përzierës për sa më sipër, nëse janë ose jo në ndonjë tretës
Duhani, cigaret, cigaret elektronike
Vajrat esenciale (të terpenes ose jo), përfshirë të ngurta dhe absolute; rrëshirat; koncentratet e vajrave esenciale në yndyrna, në vajin yndyror, në dyllë apo edhe të marra nga tretja e gjetheve të thara; nënproduktet terpenike që merren nga deterpenimi i vajrave esenciale; distilatet ujore e solucionet ujore të vajrave esenciale

SHTOJCA 2

NIVELET MAKSIMALE TË LEJUARA PËR KONTAMINIMIN RADIOAKTIV TË USHQIMEVE PËR KAFSHËT SI REZULTAT I NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR OSE NJË EMERGJENCE RADIOLOGJIKE.

Nivelet maksimale të lejuara për kontaminimin radioaktiv të ushqimeve për kafshët jepen në tabelën 1. Nivelet e dhëna në tabelën 1 (shtojca 2) do të zbatohen për ushqime të gatshme për konsum nga kafshët.



Tabela 1. Nivelet maksimale të lejuara për kontaminimin radioaktiv të ushqimeve për kafshët si rezultat i një aksidenti bërthamor ose një emergjence radiologjike

Kafshët	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/kg) i Cs-134 dhe Cs-137
Derra	1.250
Shpendët, qengjat, viçat	2.500
Të tjerë	5.000

SHTOJCA 3
SHEMBULL. CERTIFIKATË EKSPORTI PËR PRODUKTET BUJQËSORE

(Kjo certifikatë mund të adaptohet nga laboratorët përkatës për çdo lloj produkti)

Deklarata nga eksportuesi		
1. Eksportuesi (emri, adresa e plotë, shteti)	5. Vendi/shteti i origjinës	6. Vendi i destinacionit
2. Marrësi i ngarkesës (emri, adresa e plotë, shteti)	7. Numri i faturës	
3. Identiteti i mjeteve të transportit	8. Numri dhe lloji i pakove	9. Shenjat dhe numrat e serisë
4. Përshkrimi i produkteve	10. Peshë bruto (kg)	11. Peshë neto (kg)
12. Unë, i nënshkruari, përgjegjës për këto eksporte, vërtetoj informacionin e mësipërm:.....		
Data..... Emri, mbiemri (me shkronja kapitale).....		
Vendi Firma (!):		
Certifikata nga laboratorit		
13. Numri i mostrave të analizuar për produktet e mësipërme, të marra nga një përfaqësues i autorizuar nga autoritetet kompetente copë	15. Identiteti i laboratorit (emri, adresa e plotë, vendi)	
14. Nivelet e radioaktivitetit të regjistruara për çdo mostër të analizuar (Bq/kg) (specifiko numrin e serisë për çdo mostër)	16. Specifiko pajisjen e përdorur për kryerjen e analizave:	
Nr. i raportit, data	17. Të akredituara nga (emri dhe adresa e trupës së akreditimit):	
<i>Ky raport duhet të paraqitet menjëherë në kërkesën e autoriteteve të kontrollit</i>	18. Data:	
	Emri, mbiemri i personit përgjegjës (me shkronja kapitale) :	
	Firma e personit përgjegjës (!):	
	Vula e laboratorit (!):.....	
Certifikata nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit		
18. Unë, i nënshkruari, vërtetoj që niveli i radioaktivitetit i akumuluar për Cs-134 dhe Cs-137 në produktet e përmendura më sipër nuk i tejkalon limitet:		
Emri, mbiemri (me shkronja kapitale)..... Firma (!):.....		
Data	Vendi	Vula (!):

1. Firmat dhe vulat duhet të jetë në një ngjyrë të ndryshme nga ajo e tekstit.



SHTOJCA 4

LLOJET E MATERIALEVE TË NDËRTIMIT QË MERREN NË KONSIDERATË LIDHUR ME EMETIMIN E RREZATIMIT GAMA

Për qëllime të nenit 17, llojet e materialeve të ndërtimit si më poshtë, të kontrollohen:

1. Materiale natyrale:

- a) argjila;
- b) materiale ndërtimi, duke përfshirë:
 - granitet;
 - inerte të ndryshme;
 - tullat me përbërje të ndryshme;
 - hekur për ndërtim.

2. Mbetjet e materialeve që vijnë nga industrinë përpunuese ku lidhen në mënyrë të natyrshme materiale radioaktive, duke përfshirë:

- a) allçi/gips fosfori;
- b) skorje të ndryshme;
- c) argjilë/baltë e kuqe (mbetje nga prodhimi i aluminit);
- ç) mbetje nga prodhimet e çelikut.

3. Çdolloj tjetër material ndërtimi për të cilin KMR-ja ka arsye të besojë që ekspozimi i brendshëm për shkak të rrezatimit gama i këtij materiali mund të kalojë nivelet e referencës të dhëna në nenin 16.

SHTOJCA 5

INDEKSI I PËRQENDRIMIT TË AKTIVITETIT PËR EMETIMIN E RREZATIMIT GAMA NGA MATERIALET E NDËRTIMIT

Për materialet e ndërtimit të listuara në shtojcën 5, aktiviteti i përqendrimit të Ra-226, Th-232 (ose produkti i shkatërrimit të Ra-228) dhe K-40 do të përcaktohen në përputhje me nenin 17/a.

Indeksi i përqendrimit të aktivitetit do të llogaritet në përputhje me nenin 19/b duke përdorur vlerat e matura të përqendrimit të aktivitetit të Ra-226, Th-232 dhe K-40 dhe formulën, si më poshtë:

$$I = \frac{C_{Ra-226}}{300 Bq/kg} + \frac{C_{Th-232}}{200 Bq/kg} + \frac{C_{K-40}}{3000 Bq/kg}$$

ku:

C_{Ra-226} , C_{Th-232} dhe C_{K-40} janë përqendrimitet e aktivitetit në Bq/kg të radiobërthamave përkatëse në materialin e ndërtimit.

Indeksi lidhet me dozën e rrezatimit gama në shtesë të ekspozimit natyror në një ndërtesë me material ndërtimi sipas shtojcës 5. Indeksi zbatohet për materialet e ndërtimit, jo për përbërësit e tyre, përveç rasteve kur këta përbërës janë materiale ndërtimi dhe vlerësohen si të tillë.

Vlera e indeksit të përqendrimit të aktivitetit 1 të përdoret si një instrument konservativ shqyrtimi për identifikimin e materialeve që mund të shkaktojnë tejkalimin e niveleve të referencës të dhëna në nenin 16. Në qoftë se indeksi e tejkalon vlerën 1, doza e publikut duhet të llogaritet duke marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë, si: densiteti, trashësia e materialit, tipi i ndërtimit dhe qëllimi i përdorimit të materialit (në pjesën më të madhe të tij apo sipërfaqësore).



SHTOJCA 6
SHEMBULL. CERTIFIKATA E MONITORIMIT TË NGARKESËS SË SKRAPIT

VENDI I MONITORIMIT	
Vendi i monitorimit:	
Emri i kompanisë/institucionit dhe personit që drejton monitorimin:	
Adresa:	
Tel/fax:	
E-mail:	
DETAJE TË NGARKESËS	
Vendi i origjinës:	
Origjina e ngarkesës së mallit/mallrave (adresa, personi i kontaktit, tel/fax, e-mail)	
Destinacioni i dërgesës: (informacion i detajuar i marrësit, kontakte)	
Identifikimi i ngarkesës: (referenca të dokumenteve të transitit që vijnë me ngarkesën)	
Mënyra e transportit: (identifikimi i kamionit, anijes, kontejnerit etj.)	
Detaje të transportuesit: (informacion i detajuar i transportuesit, kontakte)	
MATJET	
Detaje të aparaturave të përdorura gjatë monitorimit:	
Vlerat mesatare të matura 1 m nga sipërfaqja e ngarkesës ($\mu\text{Sv/h}$):	
Vlera e dozës maksimale në kontakt me sipërfaqen e jashtme të kontejnerit, kamionit ose vagonit, në $\mu\text{Sv/h}$ (identifikimi i pozicionit):	
Vlerat e rrezatimit mjedisor në zonë, në $\mu\text{Sv/h}$:	
VËRTETIM I DEKLARATËS	
Unë, i nënshkruari, vërtetoj që vlerat e mëposhtme, janë një dokument i vërtetë i matjeve të bëra gjatë monitorimit në datën si më poshtë:	
Firma.....	
Vula zyrtare e kompanisë/institucionit monitorues:	

VENDIM

Nr. 958, datë 25.11.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SHTIMI I SIPËRFAQES SË VARREZAVE PUBLIKE NË QYTETIN E VLORËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Shtimi i sipërfaqes së varrezave publike në qytetin e Vlorës”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë bujqësore” dhe “ullishte”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 753 800 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 2 753 800 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e



tetëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të

bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR PROJEKTIN
“SHTIMI I SIPËRFAQES SË VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT TË VLORËS”

Për pasuritë e llojit tokë bujqësore (ullishte)

Nr.	Emër e mbiemër	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pronës	Sipërfaqe m ²	Çmimi lekë për m ²	Vlera	Konfirmimet me AMTP	Adresa e pronarit	Shënime
1	Agush Avdullai	1060	76/13	ullishte	4540	281	1,275,740	nr. 15526	Babicë e Madhe	Saktësim dokumentacioni
2	Skender Rrapë	1060	76/11	ullishte	3500	281	983,500	nr. 15527	Babicë e Madhe	Saktësim dokumentacioni
3	Lirim Hania	1060	76/13	ullishte	1760	281	494,560	nr. 15522	Babicë e Madhe	Saktësim dokumentacioni
SHUMA							2,753,800			

Shënim

Lista e pronarëve që do të shpronësohen është plotësuar nga komisioni i vlerësimit, Bashkia Vlorë.

Meqenëse konfirmimi i pronave nuk është dhënë nga ZVRPP-ja Vlorë, por nga AMTP-ja, Komisioni i Posaçëm, i Shpronësimeve në MZHU, vendosi që në tabelë të shënohet, saktësim dokumentacioni.

Për llojin e pronës ullishte, çmimi është 281 lekë/m².

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë